

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5873  
E hënë, 9 shtator 2019  
çmimi 0.40 €

## Top dhjetëshet e partive politike në listat zgjedhore



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**SERBIA NUK E NDAL LUFTËN  
KUNDËR ANËTARËSIMIT TË  
KOSOVËS NË INTERPOL F. 6**

**VETËVENDOSJA KËRKON  
MBËSHTETJE FINANCIARE PËR  
ZGJEDHJET E 6 TETORIT F. 6**

### EKONOMI



**SHALA: TË RINJTË NGA KOSOVA  
MUND TË OFROJNË SHËRBIME  
NË FUSHËN E IT-së PËR  
KOMPANITË GJERMANE F. 9**

**SEKTORI PUBLIK MË  
I PREFERUAR PËR PUNËSIM  
SESA AI PRIVAT F. 9**

**OSMANI PREMTON  
SUBVENCIONE PËR  
PRODHUESIT VENDORË F.8**

### SPORT



**KOSOVA DUHET TË MOS  
DORËZOHET NDAJ ANGLISË F. 16**

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KA MBAJTUR KONVENTËN PËR NOMINIMIN E KADRI VESELIT KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR NË ZGJEDHJET E 6 TETORIT

# VESELI: MË 6 TETOR BËHUNI GATI PËR FITOREN E MADHE TË PDK-së



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Kadri Veseli, me rastin e nominimit kandidat për kryeministër i kësaj partie në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit, ka thënë se partia që drejton do të dalë fituese në këto zgjedhje. PDK-ja ka publikuar edhe listën e kandidatëve për deputetë në të cilën 68 kandidatë garojnë për herën e parë, kurse mbi 40 kandidatë janë nën moshën 40-vjeçare. I nominuar për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se me këtë listë emrash fitorja e PDK-së do të jetë e sigurt për zgjedhjet e parakohshme parlamentare

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGON MALIQI | FAQE 4-5

## Më 6 tetor mund të ketë befasi

**- Unë terrenin për vendin e parë e shoh mjaft të hapur**

Analisti politik Agon Maliqi ka vlerësuar se në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit mund të ketë befasi. Sipas tij, elektorati i Kosovës ka filluar të jetë më kërkues dhe më i paparashikueshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka thënë se e shoh mjaft të hapur terrenin për vendin e parë. Ai ka theksuar se në garën për vendin e parë (mbi 25 - 30 %) në pamje të parë duken favorite LDK-ja dhe IV-ja, kurse PDK-ja do ta ketë të vështirë. Ai ka thënë se aktualisht është vështirë i parashikueshëm krijimi i koalicionit qeveritar megjithatë, sipas Maliqit, dialogu me Serbinë, i cili e çoi qeverinë e kaluar drejt rënies, do të luajë rol shumë të rëndësishëm dhe mund të jetë përcaktues për krijimin e koalicionit qeverisës



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Maqedonia e Veriut shënoi 28-vjetorin e pavarësisë

Në parkun qendror të Shkupit nga qytetarë të shumtë dhe krerë të qeverisë u shënuar 28-vjetori i pavarësisë së Maqedonisë Veriore, me ç'rast kryeministri Zoran Zaev u zotua se në tetor do ta marrin datën për fillimin e negociatave me BE-në



**SHKUP, 8 SHTATOR** - Me intonimin e himnit shtetëror është mbajtur ceremonia e shënimit të Ditës së Pavarësisë së Maqedonisë së Veriut. Në parkun qendror të Shkupit festa u shënuar nga qytetarë të shumtë dhe krerë të qeverisë. Kryeministri Zoran Zaev tha se ardhmëria e vendit nuk i takon asnjë partie politike, por qytetarëve. Zaevi i bëri thirrje opozitës që të përfshihet në proceset e rëndësishme për shtetin. "Pikërisht ju qytetarët u bashkuat në një shumicë të zëshme dhe i larguat autokratët. U ngritët kundër ndarjeve dhe kundër interesave të ngushta partiake, duke dhënë porosi të qartë si neve ashtu edhe opozitës aktuale se është koha që ta ndjekim rrugën e duhur dhe të ecim përpara. Për shkak të përgjegjësisë ndaj qytetarëve, qëndroj fuqishëm në angazhimet e mia duke iu bërë thirrje të gjithëve, përfshirë edhe opozitën për çështjet e rëndësishme të na bashkëngjiten", tha kryeministri Zoran Zaev, ka njoftuar "Alsati".

Ndërkaq kreu i opozitës Hristian Mickoski Ditën e Pavarësisë vendosi ta festojë ndryshe nga pushtetarët. Ai të

dielën u ngjit në majën e Korabit në 2 764 metra lartësi mbidetare, ku përveç flamurit shtetëror dhe atij me diellin e Verginës, ngriti edhe flamurin e VMRO DPMNE-së. Ndërsa, në profilin e tij në "Facebook" dha porosinë se qytetarët duhet të festojnë dhe të bashkohen në këtë kohë të vështirë për shtetin. "Le të luftojmë për vendin tonë, në këtë kohë të pakohë, kur fuqishëm na tërheqin zvarrë deri në fundërrinë, ku jeta u bë ferr. Kurse, secili nga ju ndihet dhe e di që kjo sot nuk është ajo për të cilën kanë luftuar tanët në të kaluarën dhe ajo për të cilën ne e duam sot. Andaj së bashku të luftojmë për më mirë dhe për të ardhmen tonë. Maqedonia është emri dhe mbiemri ynë, është betimi ynë", u shpreh Hristian Mickoski, kryetar i VMRO DPMNE-së.

Në shënimin e 28-vjetorit të Pavarësisë së Maqedonisë së Veriut, kryeministri Zaev u zotua se në tetor do ta marrin datën për fillimin e negociatave me BE-në.

Presidenti i Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski, ka uruar qytetarët me rastin e 8 Shtatorit, Ditës së Pavarësisë së këtij vendi. "Në vitin 1991, në një kohë të pasigurt, ne, qytetarët, u

bashkuam rreth idesë për shtet tonin, të pavarur. Pastaj, sfida e madhe, në vend të arsyes për ndarje, u bë arsye e bashkimit, të gjithë u mblodhëm përreth idesë për një Maqedoni të pavarur dhe sovranë", tha Stevo Pendarovski në urimin për qytetarët me rastin e 8 Shtatorit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë Veriore.

Me kalimin e viteve, siç thekson presidenti, ne kemi pasur ulje dhe ngritje, gabime dhe suksese, por së bashku i kemi kapërcyer të gjitha. "Në vitin

1991 zgjodhëm pavarësinë, në vitin 2001 bashkëjetesën ndëretnike. Sot jemi para dyerve të institucioneve evropiane dhe euroatlantike. Për ta arritur qëllimin, duhet ta rivendosim unitetin që e kishim në fillim të pavarësisë. Për këtë arsye ne kemi nevojë për pajtim të qytetarëve dhe pajtimi i përhershëm kërkon institucione efektive të drejtësisë dhe integritetit", tha Pendarovski.

Pavarësia e Maqedonisë Veriore ndodhi përmes një referendumi popullor, i cili e shpalli atë shtet të pavarur dhe sovran.

Ky referendum atëkohë u bojkotua nga shqiptarët, të cilët kërkuar statusin e autonomisë dhe nuk ishin të kënaqur me pozitën e arritur në Kushtetutën e re të këtij vendi.

Sipas vlerësimeve shtetërore të asaj kohe, mbi 95 për qind të qytetarëve që dolën në referendumin e 8 shtatorit të vitit 1991 iu përgjigjën pozitivisht pyetjes së referendumi "A jeni për Maqedoni të pavarur me të drejtë të hyjë në fuqi në aleancën e ardhshme të shteteve sovranë të Jugosllavisë?".

## Meta uron Pendarovskin: Krenarë për kontributin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

**TIRANË, 8 SHTATOR** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i ka dërguar një mesazh urimi presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, me rastin e 28-vjetorit të Pavarësisë. Meta shkruan në mesazhin e tij se në drejtimin e Pendarovskit marrëdhëniet mes dy vendeve e popujve do të forcohen. Meta vlerëson kontributin jetik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut për stabilitetin dhe integrimin euroatlantik të vendit, ndërsa thotë se përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike ka ndikim në marrëdhëniet mes dy vendeve. "28-vjetori i Ditës së Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut më jep



kënaqësinë e veçantë që të përcjell, në emrin tim dhe të popullit shqiptar, urimet e përhëndetjet më të ngrohta, të përzemërta e vëllazërore për Ju dhe të gjithë

qytetarët Tuaj. Shpreh bindjen time se, falë edhe vullnetit, përvojës dhe vizionit Tuaj, marrëdhëniet e shkëlqyera të fqinjësisë e të bashkëpunimit,

që ekzistojnë ndërmjet vendeve dhe popujve tanë, do të forcohen më tej në të ardhmen.

Dëshiroj të theksoj se një ndikim shumë të madh në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve ka luajtur dhe luan adresimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve ndëretnike. Jemi krenarë për kontributin jetik që shqiptarët në Maqedoninë e Veriut japin për stabilitetin dhe integrimin euroatlantik të vendit. Jam i bindur se komuniteti maqedonas në vendin tonë do të vijojë të jetë një urë e fortë miqësie dhe bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë. Përfitoj nga rasti t'ju përgëzoj për vizionin dhe guximin në

arritjen e Marrëveshjes historike të Prespës - një shembull për gjithë rajonin - që jo vetëm do ta forcojë perspektivën euroatlantike të vendit Tuaj, por do ta bëjë rajonin tonë edhe më të sigurt. Jam i bindur se vendet tona do të bashkëpunojnë ngushtësisht në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, si dhe në rrugëtimin e përbashkët drejt Bashkimit Evropian.

Së bashku me urimet më të mira e të përzemërta për zhvillimin e përparimin e mëtejshëm të vendit Tuaj, ju lutem pranoni, zoti President, shprehjen e konsideratës sime më të lartë", ka shkruar presidenti Meta në mesazhin e tij.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur Konventën për nominimin e Kadri Veselit kandidat për kryeministër në zgjedhjet e 6 tetorit

# Veseli: Më 6 tetor bëhuni gati për fitoren e madhe të PDK-së



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Kadri Veseli, me rastin e nominimit kandidat për kryeministër i kësaj partie në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit, ka thënë se partia që drejton do të dalë fituese në këto zgjedhje. PDK-ja ka publikuar edhe listën e kandidatëve për deputetë në të cilën 68 kandidatë garojnë për herën e parë, kurse mbi 40 kandidatë janë nën moshën 40-vjeçare. I nominuari për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se me këtë listë emrash fitorja e PDK-së do të jetë e sigurt për zgjedhjet e parakohshme parlamentare

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Kadri Veseli zyrtarisht është nominuar kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të dielën në një konventë solemne të mbajtur në Sallën 1 Tetori, në të cilën kanë marrë pjesë qindra anëtarë dhe simpatizantë të kësaj partie. Hapjen e kësaj konvente e ka bërë zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj. Ai ka thënë se pas 6 tetorit kryeministër do të jetë Kadri Veseli. "PDK-ja është partia më e madhe në vend. PDK-ja është parti e besimit, e shpresës dhe e optimizmit. Kadri Veseli do të jetë kryeministri i ardhshëm i Kosovës. Kadri Veseli e ka guximin për të marrë vendime të mëdha si dhe ka fuqi për ta ndryshuar Kosovën", ka deklaruar Hoxhaj, duke shtuar se PDK-ja është qendra e politikës në Kosovë. "Të tjerët garojnë, por ne i fitojmë zgjedhjet. Të tjerët bëjnë koalicione, ne e udhëheqim qeverinë e ardhshme me Kadri Veselin kryeministër", është shprehur Hoxhaj.

Para të pranishmëve kandidati për kryeministër i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se drejtimin e Kosovës pas 6 tetorit do ta marrë PDK-ja. "Ky është emocion i jashtëzakonshëm. Më 6 tetor bëhuni gati për fitoren e madhe të

PDK-së. Është emocionues ky rrugëtim që po nisim sot. Është zotim për rrugën që do ta bëjmë për drejtimin e shtetit tonë. Kemi arritur suksese, por kemi pasur edhe gabime. Por, vetëm ata që e njohin rrugëtimin e Kosovës e dinë se cili është drejtimi që duhet ta marrë vendi ynë. 6 tetori është referendum për vendin", ka deklaruar Veseli.

Ai ka thënë se më 6 tetor PDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet për të mos i lënë të tjerët ta izolojnë dhe dështojnë Kosovën. "Më 6 tetor do të fitojmë për të treguar se ky vend ka shpresë", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se vetëm PDK-ja do të mund ta zhvillojë vendin, ta ruajë partneritetin me miqtë evropianë dhe amerikanë. "Kush mund ta mbrojë dhe zhvillojë Kosovën?

Kush mund ta luftojë korrupsionin? Kush mund ta ndalë agresionin serb ndaj Kosovës? Kush e ruan partneritetin me miqtë evropianë dhe amerikanë? Ne dimë t'i bëjmë këto. Ne do t'i bëjmë këto. Do t'i bëjë Partia Demokratike e Kosovës", ka deklaruar Veseli. Ai ka thënë se lista zgjedhore e PDK-së i përfaqëson denjësisht qytetarët e Kosovës, është lista e besimit dhe e guximit, lista e shpresës dhe përkushtimit, si dhe lista e fitores së 6 tetorit.

Top dhjetëshes së PDK-së i prin kandidati për kryeministër Kadri Veseli, i pasuar nga Hajredin Kuqi, Eliza Hoxha, Enver Hoxhaj, Valon Murati, Besa Ismaili-Ahmeti, Memli Krasniqi, Bedri Hamza, Blerta Deliu-Kodra dhe Uran Ismaili.



## LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

1. Kadri Veseli
2. Hajredin Kuqi
3. Eliza Hoxha
4. Enver Hoxhaj
5. Valon Murati
6. Besa Ismaili-Ahmeti
7. Memli Krasniqi
8. Bedri Hamza
9. Blerta Deliu-Kodra
10. Uran Ismaili
11. Xhavit Haliti
12. Safete Hadergjonaj
13. Butrint Batalli
14. Bajrush Xhemali
15. Valdete Idrizi
16. Mërgim Lushtaku
17. Elmi Reçica
18. Ganimete Musliu
19. Migjen Kelmendi
20. Abelard Tahiri
21. Evgjani Thaçi-Dragusha
22. Kujtim Gashi
23. Shaqir Totaj
24. Sabiha Shala
25. Idriz Vehapi
26. Fatmir Xhelili
27. Dhurata Hoxha
28. Ramë Buja
29. Andin Hoti
30. Ariana Musliu-Shoshi
31. Ferat Shala
32. Bajram Mulaku
33. Floretë Zejnullahu
34. Hajdar Beqa
35. Sejdi Hoxha
36. Mexhide Mjaku-Topalli
37. Rrustem Mustafa
38. Ramë Vataj
39. Aurora Bakalli
40. Fehmi Mujota
41. Hisen Berisha
42. Luljeta Veselaj-Gutaj
43. Naim Fetahu
44. Arben Bislimi
45. Gentiana Beqa-Ahmeti
46. Raif Qela
47. Izmi Zeka
48. Elmije Plaqiqi
49. Fahri Osmani
50. Kurtan Kajtazi
51. Xhevahire Izmaqi
52. Shpetim Zhegrova
53. Fadil Beka
54. Urata Tahiri
55. Shqiptar Demaqi
56. Isni Kilaj
57. Selvije Halimi
58. Blerim Latifi
59. Bear Berisha
60. Ymran Fusha
61. Fahrush Azemi
62. Fadil Nura
63. Leonora Morina-Bunjaku
64. Rafet Rama
65. Naim Ismajli
66. Gonxhe Qaushi
67. Gani Halilaj
68. Lulzim Shoshi
69. Suzana Gjergji
70. Petrit Hajdari
71. Ilir Kurtishi
72. Erleta Osmani
73. Ramush Agushi
74. Kadri Kryeziu
75. Kosovare Murseli
76. Fitim Selimi
77. Rrahim Terrnava
78. Egzona Bytyqi
79. Valon Grabovci
80. Bahri Selimi
81. Kaltrina Arifaj
82. Bekim Azizi
83. Esat Jusufi
84. Besa Kuqi
85. Isa Agushi
86. Halit Krasniqi
87. Arbresha Sylja
88. Fakir Spahiu
89. Novitet Nezaj
90. Ibadete Ahmetaj
91. Ramadan Hoti
92. Shefki Salihu
93. Merita Makolli
94. Nexhmi Muçiqi
95. Muhamet Gjoka
96. Mirjeta Rrukolli
97. Mustaf Grainca
98. Ismet Abdullahu
99. Erlira Mullabazi
100. Florim Kryeziu
101. Halit Zogaj
102. Riad Rashiti
103. Hidaim Rama
104. Faik Geci
105. Migjen Shala
106. Bejtullah Deliu
107. Gazmend Bytyqi
108. Pashk Buzhala
109. Bekim Haxhiu
110. Donjet Bislimi



Flet për "Epokën e re", Agon Maliqi

# Më 6 tetor mund

## - Unë terrenin për vendin e parë e shoh mjaft të hapur

Analisti politik Agon Maliqi ka vlerësuar se në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit mund të ketë befasi. Sipas tij, elektorati i Kosovës ka filluar të jetë më kërkuar dhe më i paparashikueshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka thënë se e shoh mjaft të hapur terrenin për vendin e parë. Ai ka theksuar se në garën për vendin e parë (mbi 25 - 30 %) në pamje të parë duken favorite LDK-ja dhe LV-ja, kurse PDK-ja do ta ketë të vështirë. Ai ka thënë se aktualisht është vështirë i parashikueshëm krijimi i koalicionit qeveritar megjithatë, sipas Maliqit, dialogu me Serbinë, i cili e çoi qeverinë e kaluar drejt rënies, do të luajë rol shumë të rëndësishëm dhe mund të jetë përcaktues për krijimin e koalicionit qeverisës

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Njohësi i rrethanave politike dhe zgjedhore Agon Maliqi ka thënë të dielën se gara për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit është po aq e paqartë për t'u parashikuar sa janë të paqarta edhe ofertat programore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kontrasti mes ofertës politike dhe peshës historike të momentit nuk mund të ishte më i madh. "Partitë janë bërë një mishmash jokohorent. I hap ekranet dhe dëgjon vetëm akuza, zëra të ngritur dhe gishta të drejtuar sa këndej e sa andej. Ndërkohë, Kosova është përballë sfidave tepër të mëdha, qoftë në rrafshin e brendshëm, qoftë në atë ndërkombëtar për të cilat partitë duhej të jepnin qartësi", është shprehur Maliqi.

Ai ka vlerësuar se më 6 tetor mund të ketë befasi meqë, sipas tij, elektorati i Kosovës ka filluar të jetë më kërkuar dhe më i paparashikueshëm. Në këtë kontekst, Maliqi e shoh të hapur terrenin për vendin e parë. "Pa

dyshim, është krejt e mundshme se do të ketë befasi. Elektorati i Kosovës ka filluar të jetë më kërkuar dhe më i paparashikueshëm. Me gjasë në asnjë palë zgjedhje nuk ka qenë më e rëndësishme cilësia e fushatës. Unë terrenin për vendin e parë e shoh mjaft të hapur", ka deklaruar ai, duke shtuar se në garën për vendin e parë (mbi 25 - 30 %) në pamje të parë duken favorite LDK-ja dhe VV-ja, kurse PDK-ja do ta ketë të vështirë.

Maliqi ka thënë se aktualisht është vështirë i parashikueshëm krijimi i koalicionit qeveritar megjithatë, sipas tij, dialogu me Serbinë do të luajë rol shumë të rëndësishëm dhe mund të jetë përcaktues për krijimin e koalicionit qeverisës.

**"Epoka e re":** Z. Maliqi, si e shihni garën zgjedhore të 6 tetorit, ku tri partitë më të mëdha në vend, LDK, PDK dhe LV, do të garojnë të vetme dhe katër të tjera në dy koalicione parazgjedhore, AAK - PSD dhe Nisma - AKR?

**Maliqi:** Është një garë po aq e



paqartë për t'u parashikuar sa janë të paqarta edhe ofertat programore. Partitë janë bërë një mishmash jokohorent. I hap ekranet dhe dëgjon vetëm akuza, zëra të ngritur dhe gishta të drejtuar sa këndej e sa andej. Ndërkohë, Kosova është përballë sfidave tepër të mëdha qoftë në rrafshin e brendshëm, qoftë në atë ndërkombëtar, për të cilat partitë duhej të jepnin qartësi. Kontrasti mes ofertës politike dhe peshës historike të momentit nuk mund të ishte më i madh.

**"Epoka e re":** Pavarësisht prej përpjekjeve, nuk u arrit koalicioni parazgjedhor në mes të LDK-së dhe LV-së. Pse dështoi ky koalicion dhe a ka qenë e përnjëmendte arritja e një marrëveshje?

**Maliqi:** Personalisht mendoj se krerët e të dyja palëve nuk deshën koalicion, por në rrethanat e një presioni, nga një pjesë e elektorateve kundër PDK-së brenda të dyjave, u përpoqën të dukeshin sikur e donin koalicionin dhe t'ia linin fajin palës tjetër për dështimin,

për të fituar benzinë nga sentimentin kundër PDK-së. Në këtë betejë perceptimesh duket sikur me atë letrën publike të ditës së fundit të negociatave, fitues doli Albin Kurti. Në realitet, problemi me këtë koalicion nuk ishte vetëm mandatarin, por edhe dimensionin programor dhe aspektin praktik i zbatimit. Votuesit e një koalicioni të tillë e dinin se kundër kujt ishte ky koalicion, por nuk do ta dinin se pro çkajë ishte, sidomos në rrethanat kur Kosova është përballë disa sfidave të mëdha.

## Mark Gjonaj kërkon nga diaspora të votojë më 6 tetor

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Anëtarin e këshillit bashkiak i Nju Jorkut, Mark Gjonaj, ka kërkuar nga komuniteti shqiptar që të marrë pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë, duke votuar përmes postës. "Shpresoj që pjesëmarrja në zgjedhje të jetë e madhe. Është e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Diaspora ka rastin të marrë pjesë në zgjedhje, me një

afat regjistrimi deri më 10 shtator. Inkurajoj të gjithë ata që kanë të drejtë vote, të regjistrohen brenda afatit për të marrë pjesë në një proces të besueshëm dhe demokratik, që do t'i japë formë të ardhmes së Kosovës. Është përgjegjësi e njerëzve tanë ndaj vendlindjes", ka thënë Gjonaj në një intervistë për "Zërin e Amerikës". Në këtë intervistë,

Gjonaj ka folur edhe për taksën prej 100 përqindësh që Kosova ka vendosur ndaj mallrave serbe, duke theksuar se Beogradi e ka përdorur taksën si justifikim për t'u larguar nga tryeza e bisedimeve. "Nuk ishte Kosova ajo që i ndali bisedimet. Kosova gjithmonë ka qenë në tryezë, Serbia është larguar nga ajo në mes të procesit. Tarifa është e parëndësishme dhe

ka shumë pak ndikim në mirëqenien ekonomike në Serbi. U shfrytëzua si justifikim për t'u larguar. Serbia duhet të qëndrojë në atë tryezë në mënyrë që të adresohen çështjet e vërteta. Pavarësia e Kosovës nuk është fituar. Është paguar për të. Është paguar me gjak dhe dekada të tëra diskriminimi", është shprehur Gjonaj.



# të ketë befasi



Është e çuditshme të votosh për dikë e të mos dish kush është kandidati për kryeministër. Përkundër pikave të përbashkëta në dimensionin kundër PDK-së, Osmani dhe Kurti janë politikisht shumë të ndryshëm dhe kësajsoj "kontrata politike" do të ishte shumë e paqartë. Mendoj se u bë mirë se besimi po peshohet ndaras, pastaj mbi bazën e kësaj do të mund të ndërtohej (nëse ndërtohet) një koalicion i bazuar në parime programore.

**"Epoka e re":** Kush mendoni se janë pretendentët për t'i fituar zgjedhjet?

**Maliqi:** Mendoj se ky është viti më i paparashikueshëm dhe ne si komentues rrezikojmë të bëhemi arrogantë kur flasim pa të dhëna konkrete nga anketat. Por, nga gara për vendin e parë krijohet përshtypja se mund të eliminohen koalicionet Nisma-AKR dhe AAK-PSD. Ndërkohë që Nisma-AKR-PD synon (dhe me gjasë do të dalë ta kalojë) pragun, koalicioni AAK-PSD mund të ketë rezultat të mirë,

por le të themi rreth 15 përqindëshit dhe do të befasonte po të afrohej te 20 përqindëshi. AAK-ja kësaj here i ka disa dinamika në favor të vetin: popullaritetin e masave si taksa; faktin se ishte në pushtet për dy vjet dhe pati mundësi të ushqente me favore (rrugë, punësime etj.) si dhe aftësitë organizative dhe mediatike të ekipit nga PSD. Por hapësirën për zgjerim të votës e ka të kufizuar. Sidoqoftë, gara kryesore është ajo për vendin e parë (mbi 25-30 %) ku në pamje të

parë duken favorite LDK-ja dhe LV-ja. Nominimi i Vjosa Osmanit duket se ka ngjallur entuziazëm tek elektorati tradicional i partisë dhe në një garë të ngushtë, pak gjëra janë më të rëndësishme se mobilizimi i strukturave. Por, do të varet nga fushata nëse Osmani do të mund të zgjerohet më tej drejt votuesve që ndër vite janë larguar prej LDK-së. Problemi i LDK-së është se jo rrallë dinë t'i humbin penalltitë nga vetëkënaqësia. Shumëçka varet edhe nga lista e deputetëve dhe cilësia e fushatës, prandaj mendoj se rezultati i mundshëm i LDK-së është minimumi ai që e kishte herën e kaluar (pra nuk pres rënie të votës), e maksimumi diçka rreth përqindjes që herën e kaluar e kishte LV-ja, pra rreth 30 për qind. LV-ja duket gjithashtu mjaft e mobilizuar, e motivuar dhe aset kryesor e ka popullaritetin e Kurtit. Problemi me LV-në është se nuk duket se ka arritur të krijojë ekip dhe as nivel organizativ të llojit të cilin e kishte në zgjedhjet e fundit kur u bë partia më e madhe. Kishte numër të konsiderueshëm dhe impresiv aderimesh, por ato ishin të momentit të fundit dhe nuk janë ngjizur mirë. Përqindja e LV-së është më së vështiri e parashikueshme. Mendoj se nuk shkon përfund 20 përqindëshit sepse LV-ja vazhdon të llogarisë në votën e protestës, por e shoh të vështirë përsëritjen e rezultatit të kaluar kur ishin bashkë me ata që sot janë në PSD, sepse kësaj here momentumin ia ul Vjosa Osmani. PDK-ja në anën tjetër duket se e ka betejën më të vështirë drejt vendit të parë. Hapësirën e zgjerimit dhe rritjes së votës e ka të vogël për shkak të konsumimit nga pushteti, ndërkohë që prej vitesh mjaft të pakënaqur janë larguar. Por frika nga humbja apo edhe nga fitorja e "armikut historik", LDK-së, mund të jetë faktor mobilizues i bazës së

PDK-së. Gjithashtu, aspekti organizativ gjithmonë ka qenë ana e fortë e PDK-së njësoj edhe si aftësia për të bërë fushatë profesionale. Këtu shumëçka varet edhe nga lista elektorale ku Kadri Veseli duhet të manovrojë mes "listës së pastër" dhe të fortëve lokalë me aktakuza që mbledhin vota. Mendoj se në këtë përpjekje PDK-ja, megjithatë, do të marrë në thua në këmbët e veta dhe e ka të vështirë vendin e parë.

**"Epoka e re":** A prisni befasi më 6 tetor?

**Maliqi:** Pa dyshim, është krejt e mundshme se do të ketë befasi. Elektorati kosovar ka filluar të jetë më kërkuar dhe më i paparashikueshëm. Me gjasë, në asnjë palë zgjedhje nuk ka qenë më e rëndësishme cilësia e fushatës. Unë terrenin për vendin e parë e shoh mjaft të hapur.

**"Epoka e re":** Si e shihni krijimin e institucioneve të reja, kush me kë do të qeverisë dhe kush do mbetet në opozitë?

**Maliqi:** Kjo pjesë mbetet shumë spekulative. Disa gjëra, megjithatë, duken më qartë. Duket vështirë i pararendueshëm skenari që PDK-ja të mbetet në qeveri nëse nuk del në vend të parë. Nisma-AKR-PD dhe AAK-PSD në anën tjetër po pozicionohen si partnerë koalicioni, të dyja me preferencë për LDK-në. Kushdo që e merr vendin e parë do të ketë "meny të gjerë" dhe do të jetë në pozitë të fortë negociuese. Por le ta themi se LV-ja e ka menynë e partnerëve më të ngushtë sepse shihet si partnere e vështirë. LDK-ja në vend të parë do të ishte në pozitë më komode. Gjithashtu, një gjë që nuk duhet harruar është se dialogu me Serbinë, i cili e çoi qeverinë e kaluar drejt rënies, do të luajë rol shumë të rëndësishëm, në mos edhe përcaktues për krijimin e koalicionit.

## Serbia nuk e ndal luftën kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Serbia është duke i vazhduar sërish përpjekjet për ta parandaluar anëtarësimin e Kosovës në organizatën më të madhe të policisë ndërkombëtare, Interpol. Ministri i Brendshëm i Serbisë, Nebojsa Stefanović, ka thënë se ai do të tregojë në Asamblesë të Përgjithshme të Interpolitit e cila do të mbahet

në tetor në Kili, se nuk ka arsye politike dhe as ligjore që Kosova të anëtarësohet në këtë organizatë. "Ne nuk do të lejojmë që seanca e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolitit të kalojë pa luftën tonë. Unë do ta drejtoj delegacionin tonë dhe do të largohem herët për të folur me një numër të ministrave të Brendshëm të cilët, në

esencë, vendosin rreth votimit", ka thënë Stefanović për "TV Prva". Tentativat e Kosovës për anëtarësim në Interpol kanë nisur që nga viti 2010. Atëkohë Komiteti Ekzekutiv i kësaj organizate nuk e kishte marrë fare parasysh kërkesën e parashtruar nga Prishtina zyrtare. Më 2015 dhe 2016 Kosova

kishte aplikuar, por nuk ishte futur në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme. Më 2017 Kosova pati tërhequr vullnetarisht kërkesën për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme. Serbia së bashku me aleatët po vazhdon lobimin kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare.



## PDK-së i bashkohen mbi 100 aktivistë të AAK-së, reagon partia e Haradinajt

VUSHTRRI, 8 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë me dije se kësaj partie në Vushtri i janë bashkuar mbi 100 aktivistë të AAK-së. Ai ka thënë se kanë besim dhe shpresë te qytetarët e Kosovës për ta fituar luftën kundër korrupsionit. "Partia Demokratike e Kosovës, si subjekti më i madh politik në vend, po vazhdon të rritet edhe më shumë në çdo lagje, fshat e qytet. Luftës sonë kundër korrupsionit dhe nepotizmit sot iu bashkuan edhe mbi 100 aktivistë të AAK-së, pjesë e strukturave të saj në Vushtri. Ne jemi besim dhe shpresë për të gjithë qytetarët tanë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa Dega e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka demantuar lajmin për aderimin e mbi 100 aktivistëve të kësaj partie në PDK. Kjo degë ka kërkuar nga PDK-ja që ta bëjë

publike listën e aktivistëve të AAK-së që i janë bashkuar partisë së Kadri Veselit. "Dega e AAK-së në Vushtri është befasuar nga lajmi mashtrues i lëshuar në publik kinse 'mbi 100 aktivistë të AAK-së' aderuan në PDK. Ne që jetojmë në Vushtri e njohim të gjithë njëri-tjetrin dhe angazhimin politik të secilit. Jo më shumë se pesë persona kanë qenë ish-aktivistë të AAK-së, të cilët në kërkim të punësimit personal kanë bërë lëvizje në subjekte të tjera politike. Ne u bëjmë thirrje publike atyre që e kanë publikuar lajmin, të bëjnë publike edhe listën e personave. Jo për ne, sepse ne e dimë të vërtetën, por për qytetarët e Vushtrrisë", është thënë në reagimin e Degës së AAK-së në Vushtri. Sipas kësaj dege, PDK-ja është duke i joshur qytetarët me punësime në ndërmarrje publike. "Ne i kuptojmë edhe problemet personale të qytetarëve dhe u urojmë punësim të lehtë. Ajo që nuk e



kuptojmë është 'lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit' e Kadri Veselit. Ndërmarrja publike 'Ibër & Lepenc', e cila në kohë fushatë

shndërrohet çdoherë në karrem për 'aderime', nuk është Degë e PDK-së, por është e qytetarëve dhe publike. Vushtrria e kupton

shumë mirë 'luftën' tuaj kundër nepotizmit dhe korrupsionit! Mashtrimi ka fund!", është thënë në këtë reagim.

## Nisma Socialdemokrate merr përkrahje nga Gjermania për zgjedhjet e 6 tetorit



PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Nisma Socialdemokrate ka marrë mbështetje të rëndësishme për zgjedhjet e 6 tetorit nga deputeti i Bundestagut gjerman, Bernd Westphal, anëtar i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë (SPD). Kjo mbështetje i është konfirmuar Enver Sopjanit, i cili është këshilltar i kreut të Nismës, Fatmir Limaj, kandidat për kryeministër të Kosovës. Gjatë një takimi që Sopjani ka pasur me Westphalin, ky i fundit ka premtuar mbështetje të rezervë për Nismën Socialdemokrate si dhe ka

shprehur gatishmëri për ta nisur bashkëpunimin mes dy partive tona si parti me orientim socialdemokrat. "Ekonomia, energjia dhe shëndetësia janë prej sektorëve më të rëndësishëm për të cilat ka nevojë Kosova. Prandaj përkrahja e Westphalit do të jetë shumë e rëndësishme për Nismën dhe Kosovën në përgjithësi", është thënë në njoftimin e Nismës. Bernd Westphal është anëtar i Komisionit Parlamentar për Ekonomi dhe Energji dhe shef i grupit i SPD-së në këtë komision. Është anëtar edhe i komisionit për Shëndetësi.

## Vetëvendosje kërkon mbështetje financiare për zgjedhjet e 6 tetorit

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar mbështetje financiare nga qytetarët e Kosovës për zgjedhjet e 6 shtatorit. Kjo lëvizje ka theksuar se është duke kërkuar mbështetje financiare për ta çliruar Kosovën nga kapësit e shtetit dhe të korruptuarit. "Ta ndihmojmë fitoren për të mirën e vendit. Të dashur miq dhe mbështetës të Lëvizjes Vetëvendosje, si në çdo zgjedhje ne u drejtohem qytetarëve për mbështetje financiare. Si subjekti më transparent në Kosovë, ne e kemi pasur një

mbështetje financiare në rritje, e cila është përkthyer edhe në rezultat më të mirë elektoral. Kësaj radhe fitorja jonë është e domosdoshme për ta çliruar shtetin e Kosovës nga kapësit e korruptuar dhe kriminalë", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.

Kjo lëvizje e cila drejtohet nga Albin Kurti ka bërë me dije se nuk pranojnë ndihmë financiare nga persona apo biznese të dyshimta. "Ne nuk pranojmë financime nga persona apo biznese të dyshimta. Nuk pranojmë

shuma të mëdha. Fuqia jonë bazohet në ndihmat e vogla, që na i jepni shumë prej jush. Andaj, me rastin e zgjedhjeve të 6 tetorit, ku Lëvizja Vetëvendosje! do të fitojë, ne duhet të bëjmë një fushatë të përkryer. Për ta arritur këtë është e nevojshme ndihma juaj. Cilado shumë që keni mundësi, pa ju ngushtuar e pa ju vënë në vështirësi, neve na ndihmon që ta sjellim më pranë kthesën e madhe. Qeveria Kurti do të jetë momenti i kthimit të Kosovës kah e mbara për të gjithë qytetarët e saj", është thënë në këtë njoftim.



# Top dhjetëshet e partive politike në listat zgjedhore

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Subjektet politike tashmë i kanë publikuar listat e kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Pothuajse në shumicën e këtyre listave topdhjetshën e parë e kanë zënë figurat kryesore të partive politike dhe koalicioneve parazgjedhore. Në dhjetëshen e parë të LDK-

së janë: kandidatja për kryeministre Vjosa Osmani, Kujtim Shala, Avdullah Hoti, Lumir Abdixhiku, Anton Quni, Lirije Kajtazi, Besian Mustafa, Driton Selmanaj, Hykmete Bajrami dhe Doruntinë Maloku. Përveç liderit të partisë, Isa Mustafës, pjesë e kësaj liste nuk është as vajza e Ibrahim Rugovës, Teuta

Rugova, që ishte deputete në dy mandatet e kaluara.

Kurse listës së Vetëvendosjes i prinë kandidati për kryeministër, Albin Kurti, i pasuar nga Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu, Arben Vitia, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haki Abazi, Xhelal Sveçla e Rexhep Selimi. Ndërsa në listën e koalicionit AAK-PSD

janë: kandidati për kryeministër Ramush Haradinaj, Visar Ymeri, Magbule Shkodra, Burim Ramadani, Anton Berisha, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Xhafer Gashi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Dukagjin Gorani. Në këtë dhjetëshen nuk është lideri i PSD-së dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, i cili është i fundit në

listë.

Ndërkaq listën zgjedhore të koalicionit Nisma-AKR-PD e kryeson Fatmir Limaj që është edhe kandidat për kryeministër, i pasuar nga Behgjet Pacolli, Albulena Balaj, Bilall Sherifi, Zafir Berisha, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Islam Pacolli, Endrit Shala, Shqipe Kupina dhe Haxhi Shala.

## LISTA E LDK-së

- Vjosa Osmani Sadriu
- Kujtim Shala
- Avdullah Hoti
- Lumir Abdixhiku
- Anton Quni
- Lirije Kajtazi
- Besian Mustafa
- Driton Selmanaj
- Hykmete Bajrami
- Doruntinë Maloku
- Ismet Beqiri
- Valon Murtezaj
- Arban Abrashi
- Arben Gashi
- Besa Gaxherri
- Fidan Rekalii
- Armend Zemaj
- Vlora Dumoshi
- Florian Dushi
- Fatmir Rexhepi
- Valentina Bunjaku-Rexhepi
- Haxhi Avdyli
- Muhamet Hamiti
- Mirjeta Kalludra
- Xhavit Rexhaj
- Nexhmi Rudari
- Florije Besholli
- Muharrem Sfarqa
- Shkemb Manaj
- Vlora Limani-Hajnuni
- Shkelzen Hajdini
- Shkumbin Gashi
- Flutura Beka
- Ekrem Hyseni
- Imet Rrahmani
- Hyre Tejeci
- Ardian Shala
- Naser Rugova
- Saranda Musliu
- Frasher Demaj
- Gezim Kokollari
- Fatbardha Emimi
- Safet Kamberi
- Faton Bislimi
- Brikenda Kryeziu
- Besart Dreshaj
- Hasan Alija
- Miketa Hajdari
- Hysni Gerguri
- Adem Salihaj
- Sadije Osaj-Jakupi
- Ukë Berisha
- Zef Morina
- Rrezarta Krasniqi
- Ilir Ferati
- Luan Gola
- Kumrije Sahiti
- Nexhat Rexha
- Selim Kryeziu
- Bekrije Cena-Nazifi
- Ibrahim Kryeziu
- Xhevdet Quni
- Ema Nikqi-Rexha
- Ilir Tasholli
- Brahim Selimaj
- Melihate Termkolli
- Dardan Bibaj
- Kujtim Prekazi
- Besa Zejnullahu
- Faik Zekaj
- Ruzhdi Shehu
- Shqipe Ramaj

## LISTA E LV-SË

- Xhavit Ukaj
- Haki Demolli
- Arta Metaj-Govori
- Shefki Gashi
- Bajrush Ymeri
- Marigona Lala
- Ibish Mazreku
- Rexhep Gjergji
- Sevdije Alshiqi
- Milaim Berisha
- Hatim Baxhaku
- Ardita Dushi
- Bexhet Kuqi
- Shefqet Osmani
- Naime Osmani
- Avdi Pireva
- Visar Hoti
- Ganimete Ismajli
- Fahri Uka
- Fitim Havolli
- Suzana Muriqi
- Rrustem Letaj
- Fetah Rudi
- Shkendije Lokaj
- Driton Pira
- Sali Caca
- Mimoza Shahini
- Faton Peci
- Hamdi Jaha
- Imri Hashani
- Selim Shabani
- Veton Ademi
- Enver Krasniqi
- Isuf Berisha
- Bahar Berisha
- Haki Raqi
- Fadil Vezej
- Arton Gjoka

## LISTA E LV-SË

- Albin Kurti
- Glauk Konjufca
- Albulena Haxhiu
- Arben Vitia
- Yllza Hoti
- Liburn Aliu
- Fatmire Mulhaxha - Kollçaku
- Haki Abazi
- Xhelal Sveçla
- Rexhep Selimi
- Arbërie Nagavci
- Hekuran Murati
- Fitore Pacolli
- Taulant Kryeziu
- Hajrulla Çeku
- Avni Zogiani
- Saranda Bogujevci
- Jahja Koka
- Ismajl Kurteshi
- Mefail Bajqinovci
- Vlera Gjakova
- Valon Ramadani
- Mimoza Kusari - Lila
- Fitim Uka
- Hydajet Hyseni - Kaloshi
- Mevlyde Hyseni
- Shpejtim Bulliqi
- Faruk Mujka
- Artan Abrashi
- Tinka Kurti
- Sylejman Çerkezi
- Beni Kizolli
- Arijeta Rexhepi
- Arbër Rexhaj

## LISTA E KOALICIONIT AAK-PSD

- Ramush Haradinaj
- Visar Ymeri
- Magbule Shkodra
- Burim Ramadani
- Anton Berisha
- Shqipe Pantina
- Pal Lekaj
- Xhafer Gashi
- Donika Kadaj-Bujupi
- Gani Krasniqi
- Muhamet Kelmendi
- Burbuqe Bakija Deva
- Sali Salihu
- Gazmend Abrashi
- Teuta Haxhiu
- Xhavit Zariqi
- Ahmet Isufi
- Besa Baftiu
- Shkumbin Demalijaj
- Frashër Krasniqi
- Albena Reshitaj
- Muharrem Nitaj
- Kaqusha Jashari
- Driton Bardheci
- Dardan Sejdiu
- Besnik Tahiri
- Time Kadrijaj
- Blerim Kuçi
- Ali Berisha
- Natyra Kuçi
- Bajram Hasani
- Genc Bashota
- Iliriana Gafuri
- Idriz Selimaj
- Shyqyri Bytyqi
- Zoja Berisha Lleshi
- Faruk Nura
- Erolld Belegu
- Blinera Dudi Sheholli
- Gani Dreshaj
- Drita Krasniqi
- Gëzon Kastrati
- Rexhep Kadriu
- Bekë Berisha
- Aida Rushiti
- Çamerie Azemi
- Rrustem Berisha
- Labinot Tahiri
- Marqë Selmani
- Daut Haradinaj
- Fisnik Ismaili
- Rasim Selmanaj
- Lulzim Kabashi
- Fiknete Bejta
- Gegë Lleshi
- Gazmed Sylja
- Mrika Thaqi
- Ramiz Qeriqi
- Lahudin Mmyrtaj
- Afrore Mazreku
- Lahi Ibrahimaj
- Fatos Axhemi
- Luljeta Berisha
- Vehbi Imeri
- Dardane Sadiku
- Granit Shala
- Arber Tolaj
- Nexhmendin Bajrami
- Besa Luzha
- Nehat Maxhuni
- Hali Matoshi
- Drita Kukaj
- Eleonora Çeku-Kryeziu

## LISTA E KOALICIONIT NISMA-AKR-PD

- Fatmir Shurdhaj
- Hekuran Sejdiu
- Naim Bazaj
- Qamile Morina
- Hajrush Kurtaj
- Sali Lajqi
- Shqipe Kastrati
- Shyqyri Mema
- Afrim Hoti
- Ramize Shala
- Rifta Deri
- Besim Muhadri
- Arta Ahmeti- Xhyllani
- Ilir Baldedaj
- Florinë Krasniqi
- Dardan Molliqaj
- Fatmir Iska
- Alush Shala
- Pranvera Ejupi-Hajzeraj
- Jahir Morina
- Resul Sinani
- Dhurata Salihu
- Brahim Mehmetaj
- Faton Jakupi
- Hatixhe Bungu
- Driton Çausi
- Dervish Tahiri
- Jeton Zogjani
- Vlora Jashanica
- Dukagjin Vesvesja
- Samet Dalipi
- Yll Bogaj
- Ramiz Llugagjiu
- Fisnik Dema
- Naser Pajaziti
- Shpend Ahmeti

## LISTA E KOALICIONIT NISMA-AKR-PD

- Fatmir Limaj
- Behgjet Pacolli
- Albulena Balaj
- Bilall Sherifi
- Zafir Berisha
- Mirlinda Sopi - Krasniqi
- Islam Pacolli
- Endrit Shala
- Shqipe Kupina
- Haxhi Shala
- Valdrin Lluka
- Valdete Bajrami
- Enver Hoti
- Skender Reçica
- Refiqe Beka - Ternava
- Bekim Brestovci
- Jeton Svirca
- Arbëreshë Krasniqi
- Vesel Makolli
- Dardan Krasniqi
- Arbenita Halilaj Krasniqi
- Fatmir Matoshi
- Heset Sahiti
- Suzana Sejdijaj
- Besnik Berisha
- Sami Hajdaraj
- Aferdita Gjonbalaj - Stublla
- Nysret Çubrel
- Agim Çaka
- Shukrije Bytyqi
- Isa Xhemajlaj
- Fazli Hoxha
- Myzejene Selmani
- Ekrem Mustafa

## LISTA E KOALICIONIT NISMA-AKR-PD

- Sevdail Robelli
- Albana Bytyqi
- Fehmi Hysenaj
- Abdullah Vojvoda
- Arbanë Hajdaraj
- Musa Dervishaj
- Muhamet Gashi
- Sevdije Lama
- Arianit Ibrahim
- Kastriot Sylejmani
- Zejnije Veliu
- Sedat Ismajli
- Gëzon Berisha
- Merita Dervishi
- Afrim Bektashi
- Xhemajl Hazizi
- Violeta Dema
- Skender Avdyli
- Enver Shala
- Erjona Ramaj
- Rexhep Mazreku
- Abdullah Mehmeti
- Alma Lamcja
- Shukri Quni
- Vesel Krasniqi
- Valentina Bajrami
- Driton Ademi
- Imer Rogova
- Hajrije Gashi
- Albert Sermahaj
- Musa Fetahaj
- Drenushe Hajzeri-Geci
- Shkodran Imeraj
- Xhemajl Hasani
- Xhyllje Ibrahim
- Fatmir Halili
- Hasan Ahmetaj
- Qendrese Xhema
- Mervan Rexhepi
- Hyzer Gashi
- Arbnore Kelmendi
- Mehdi Thaqi
- Mustafë Haziri
- Lule Berisha-Zabelaj
- Afrim Tejeci
- Fidan Klinaku
- Sanije Rexha
- Refki Bytyqi
- Naim Asllani
- Fexherije Konushevc
- Luan Dinaj
- Agim Krasniqi
- Agnesa Hajredini
- Xhafer Plakiqi
- Edmond Dushi
- Egzonë Muharremi
- Xhevdet Krasniqi
- Vesel Nezir
- Shkurte Berisha
- Ali Halimi
- Astrit Xhinovci
- Hyrije Gashi-Kodra
- Jenuz Berisha
- Artan Haziri
- Fatime Jasiqi
- Tasim Halabaku
- Bajram Tahiri
- Bahri Bokshi
- Hyzri Vishi
- Adem Qemali
- Eqrem Berisha
- Liman Krasniqi
- Haxhi Hoti
- Shumzim Bujupi
- Lumni Krasniqi
- Xhevdet Smakiqi

# Mbështetja 20-vjeçare gjermane për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Rreth 18 500 shtetas të Kosovës gjatë vitit 2015 janë riatdhesuar në shtetet perëndimore. Papunësia e madhe në vend dhe moszhvillimi ekonomik ishin arsyt kryesore pse kishte ndodhur largimi masiv gjatë asaj periudhe. E Stacioni i Autobusëve në Prishtinë ishte vendi më i frekuentuar në atë kohë. Por, shumë persona që ia mësynë rrugës së kurbetit janë kthyer të zhgënjyer në Kosovë, pasi atyre nuk u janë pranuar kërkesat për azil.

Në mesin e tyre është edhe Sadija Bekteshi nga Obiliqi. Ajo ka thënë se kishte marrë vendim që së bashku me vajzën dhe bashkëshortin e saj të nisen për në Gjermani për shkak të gjendjes ekonomike. Pas kthimit në Kosovë ajo ka thënë se ka vazhduar të mbajë trajnime për rrobaqepësi, zanat ky me të cilin ishte marrë edhe më herët. Më pak se një vit nga koha që është kthyer në Kosovë ajo ishte përfituese e një granti në vlerë tre mijë euro nga GIZ-i gjerman, i cili e ka mbështetur edhe për hapjen e një biznesi të vogël. Sadija përveç që tashmë

ka biznes të vet, ajo ka të punësuar dy punëtorë, ndërsa tre të tjerë mësojnë zanatin nga ajo. Ajo ka thënë se është kënaqësi që si biznes i vogël po u hap mundësi të rinjve në Obiliq për punësim.

Ndërsa Rahim Trepça, këshilltar në projektin "Dimak" në GIZ-in gjerman, ka thënë se Sadija nuk është i vetmi rast që ka përfituar nga GIZ-i. Në Prizren tash e sa kohë është hapur edhe Zyra e Informacionit për Turizëm, e cila operon si një partneritet publiko-privat ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe agjencisë private "Sharri Eco Tour".

Në dy dekada bashkëpunim, partnerët gjermanë janë përkujdesur edhe për turizëm në Kosovë. Ata kanë ndihmuar në hapjen e kësaj zyre. Burrë e grua, si pronarë të kësaj zyre turistike, tashmë promovojnë bukuritë e qytetit historik, duke ofruar shëtitje në distanca të gjata dhe shëtitje me biçikletë malore përgjatë kufirit të përbashkët ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Në 20-vjetorin e bashkëpunimit Kosovë - Gjermani, Ambasada



Gjermane në Prishtinë, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) dhe Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), kanë vendosur t'i nxjerrin në pah disa nga projektet më efektive të realizuara që nga

koha kur Kosova ka shpallur pavarësinë. Sekretarja e parë Anja Becky ka treguar se cilat janë fushat në të cilat fokusohen për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Sipas saj, Kosova është e gatshme të bashkëpunojë dhe të jetë e

përkushtuar për të bashkëfinancuar për të kontribuar përmes burimeve që janë në dispozicion. Gjermania është ndër vendet që ka ndihmuar më së shumti rimëkëmbjen e shoqërisë së Kosovës që nga përfundimi i luftës.

## I riu nga Tirana punësoi 140 persona në Kosovë



Fiorin Dervishi nga Tirana para tre vjetësh ka hapur një qendër të thirrjeve në Kosovë, në të cilën ka punësuar 140 persona. Ai ka thënë se pengesa e vetme që ka hasur në fillim ka qenë paragjykimi i kësaj industrie, si një vend pune jodinjitoz. Dervishi ka theksuar se Kosova është një vend i vogël politikisht dhe administrativisht, por kapaciteti i saj zhvillues, talenti i të rinjve dhe mundësitë që të ofron tregu, janë shumë të mëdha dhe konkurruese me vendet e rajonit

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Nga viti në vit tregut të Kosovës po i shtohen miliona euro investime në të bërit biznes nga Shqipëria. Potenciali i të rinjve për njohjen e gjuhëve të huaja dhe komunikimi është bërë arsye që një nga investimet të jenë qendrat e thirrjeve. Fiorin Dervishi nga Tirana këtë "start up" e ka nisur në Prishtinë para tre vjetësh me një ekip prej vetëm 9 personash, për t'u zhvilluar tash me një ekip prej 140 personash dhe një

moshë mesatare 22-25 vjeç. Ai ka treguar se pengesa e vetme që e ka hasur ishte paragjykimi i kësaj industrie, si një vend pune jodinjitoz. "E para e punës jemi shqiptarë dhe ndihma e parë që duhet të bëhet është hapësira shqiptare, apo hapësirat shqipfolëse. Kosova është një vend i vogël politikisht dhe administrativisht, por kapaciteti zhvillues, talenti i të rinjve dhe mundësitë që të ofron tregu janë shumë të mëdha, konkurruese me vendet

e rajonit. Kështu që, Kosova ka qenë një vendim i vështirë, por mendoj se është vendimi më i zgjuar që kemi bërë për të ardhur këtu dhe për të zhvilluar aktivitetin tonë edhe në Kosovë", ka thënë Dervishi për "Top Channel".

Ai ka thënë se zhvillimi i biznesit varet nga aftësitë zhvillimore. "Sigurisht se ka një lloj të mbështetjes të 'start up'-ve dhe një lloj lehtësime nga ana e politikave shtetërore për zhvillimin e biznesit. Pra, unë nuk ndihem i paragjykuar për shkak se jam i Shqipërisë dhe vij ta bëj një biznes në Kosovë. Përndryshe, gjithçka varet nga aftësitë tona për ta zhvilluar biznesin. Ky është faktori kryesor", është shprehur Dervishi. Ndërsa politika fiskale e shtetit, që TVSh-ja të mos paguhet për investimet nën 30 mijë euro, kishte qenë një shtytje e madhe për të. Vetëm në gjashtëmuorin e parë të këtij viti 16.4 milionë euro janë investimet nga Shqipëria, duke shënuar rritje për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 14 milionë eurosh. Investimet janë rritur edhe në periudhën njëvjeçare të 2018-s, në 23 milionë euro për dallim nga viti 2017 që ishin 2.4 milionë. E viti i artë i investimeve ka qenë 2015-ta, me plot 40 milionë euro.



# Sektori publik më i preferuar për punësim sesa ai privat

Pavarësisht se sektori privat është punëdhënësi më i madh në Kosovë, punëkërkuarit në vendin tonë më shumë preferojnë sektorin publik. Pagat më të larta, trajtimi i punëtorëve si dhe kontratat më të favorshme janë disa nga arsyet që janë cekur nga punëkërkuar dhe përfaqësues të bizneseve si elemente që bëjnë sektorin publik më të pëlqyer për t'u punësuar. Drejtori i OEAK-ut, Arian Zeka, ka thënë se arsyeja pse sektori publik është më atraktiv për fuqinë punëtore është siguria ekonomike dhe ndjenja që njerëzit krijojnë se kanë një vend pune më të qëndrueshëm dhe më të sigurt



**PRISHTINË, 8 SHTATOR** - Sektori privat, edhe pse sipas statistikave është punëdhënësi më i madh në Kosovë, mbetet nën hijen e sektorit publik, i cili vazhdon të jetë më i pëlqyer për punëkërkuarit.

Pagat më të larta, trajtimi i punëtorëve si dhe kontratat më të favorshme janë disa nga arsyet që cekën nga punëkërkuar dhe përfaqësues të bizneseve si elemente që e bëjnë sektorin publik më të pëlqyer për t'u punësuar. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se arsyeja pse sektori publik është më atraktiv për fuqinë punëtore është siguria ekonomike dhe ndjenja që njerëzit krijojnë se kanë një vend pune më të qëndrueshëm dhe më të sigurt. Sipas tij, në sektorin publik mbrojtja e të punësuarve është më e madhe dhe rrjedhimisht njerëzit orientohen të punojnë aty. "Pagat në sektorin publik janë rritur përgjatë viteve në mënyrë sig-

nifikante, ashtu që pastaj të gjithë, qofshin ata të punësuar ekzistues në sektorin publik ose të punësuarit e mundshëm, pra të sapo të diplomuarit e kanë parë vetëm sektorin publik si mundësi për ta zhvilluar karrierën e tyre. Kjo është në kundërshtim ndoshta me të gjitha praktikat e tjera ndërkombëtare ku zakonisht sektori privat është ai që ofron kushte më të mira dhe mundësi më të mëdha për zhvillim të karrierës dhe avancim të të punësuarve", është shprehur Zeka.

Ndërsa Adnan Selimi, i cili është në kërkim të një vendi pune, ka thënë se preferon sektorin publik për punësim dhe jo atë privat. Sipas tij, janë shumë arsye që puna në sektorin publik është më atraktive. "Sektori publik respekton Ligjin e punës, nuk shkel të drejtat e punëtorëve, po ashtu pagat janë më të larta, orari i punës është i rregullt 8 orë dhe jo 12 e 13 orë sa punohet në sektorin privat. Të gjitha këto më bëjnë ta pëlqej punësimin në

sektorin publik", ka deklaruar Selimi.

Ngjashëm është shprehur edhe një qytetar tjetër, me emrin Hysni Nimani. "Sektori privat nuk mbron punëtorët, kushtet e punës nuk janë të mira, nuk ka siguri financiare, nuk ka kontrata pune dhe të largojnë nga puna kurdo që ata duan", ka thënë ai. Nga hulumtimet e bëra nga përfaqësues të cilët mbrojnë të drejtat e punëtorëve ishte theksuar se sektori privat është shkelësi më i madh i të drejtave të punëtorëve.

Ndërkohë, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 85 mijë qytetarë janë të punësuar në sektorin publik, kurse në sektorin privat janë të punësuar rreth 250 mijë punëtorë. Dallimet sa iu përket kushteve të punës në mes të sektorit privat

dhe atij publik janë të mëdha duke filluar nga pagat. Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, paga mesatare në sektorin privat në Kosovë është 384 euro, ndërsa në sektorin publik paga mesatare është rreth 500 euro.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se sektori publik e ka shfrytëzuar mundësinë e ngritjes së pagave edhe për sigurimin e pushtetit gjë që, siç thotë ai, ka ndikuar në vendimet e shpeshta për ngritje të pagave. Ai ka thënë se me para të sektorit privat që kontribuojnë në mbushjen e arkës së shtetit, sektorit publik i është mundësuar rritja e pagave. Duke rritur pagat në sektorin publik, ka thënë Zeka, janë shkaktuar dëme për sektorin privat i cili, sipas tij, edhe ashtu

ka vështirësi për gjetjen adekuate të fuqisë punëtore. "Pavarësisht prej rekomandimeve tona si Odë Ekonomike Amerikane dhe mekanizmave ndërkombëtarë se kjo mund të ndikojë në thellim të deficitit buxhetor, janë rritur pagat në sektorin publik. Fatura e sotme për paga është e madhe", është shprehur Zeka. Buxheti i Kosovës për vitin 2019 kap shumën në 2.3 miliardë euro. Nga kjo shumë, mbi 600 milionë euro janë për kategorinë paga dhe mëditje. Papunësia në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, është 29.6 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 55.4 për qind. Nga kjo shifër mbi 19 për qind e të papunëve janë persona që kanë përfunduar arsimin terciar.

## Osmani premtion subvencione për prodhuesit vendorë



Prishtinë, 8 shtator (ER) - Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, ka vizituar të dielën kompaninë e qumështit "Euroлона". Osmani para medieve ka thënë se një prej temave që do të angazhohet si kryeministre e ardhshme është siguria në ushqim. Osmani ka

treguar masat që do t'i marrë për t'ua lehtësuar punën këtyre kompanive. "Ajo çka duhet të bëjmë është që shteti i Kosovës t'i përkrahë më shumë në mënyrë që prodhimet vendorë të jenë ato që konsumojnë qytetarët tanë. Besoj fuqishëm që shteti dhe institucionet vendorë duhet të blejnë vetëm prodhime ven-

dore. Ne do të ndërmarrim masa duke hequr akcizën në naftë dhe subvencione të shumta", ka thënë Osmani.

Ndërsa pronari i kompanisë së qumështit "Euroлона", Milazim Berisha, është shprehur falënderues për këtë vizitë, teksa ka thënë se pret që të largohen të gjitha barrierat që i kanë.

## Shala: Të rinjtë nga Kosova mund të ofrojnë shërbime në fushën e IT-së për kompanitë gjermane

**PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER)** - Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafër Shala, gjatë një vizite në Gjermani është takuar me zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, me të cilin ka diskutuar për mundësitë që ka Kosova për të ofruar shërbime profesionale në fushën e teknologjisë. Shala

ka thënë se me zëvendëspresidentin Wieland, kanë folur edhe për funksionalizimin e Parkut për Inovacion dhe Trajnime në Prizren. Ai ka thënë se të rinjtë nga Kosova mund të ofrojnë shërbime në fushën e teknologjisë për kompanitë gjermane. "Me zëvendëspresidentin Wieland u pajtuam që të kemi një komunikim të vazhdueshëm

me qëllim të promovimit të mundësive që i ka Kosova, ku të rinjtë tanë mund të ofrojnë shërbime profesionale në fushën e teknologjisë për kompanitë gjermane", është shprehur Shala. Gjatë kësaj vizite në Gjermani, ministri Shala ka marrë pjesë edhe në Kampin Veror në Schwabisch Gmund të Gjermanisë.



## Kuvendi Komunal në Kamenicë pranon donacionin tavolina dhe karrige

KAMENICË, 8 SHTATOR (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht Kuvendi Komunal, ka pranuar donacion nga kompania "IQ to

Link" rreth 40 tavolina dhe 35 karrige. Menaxheri i kësaj kompanie për Kosovë, Arton Dërmaku, ka thënë se ky a

inventar do t'ua lehtësoj sadopak punën e asamblistëve dhe Kuvendit Komunal. "IQ to Link", Dega

në Kosovë, është një kompani gjermane që udhëheq disa qendra produktive në Kosovë.



## Fillojnë punimet për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në Bokshiq të Klinës

KLINË, 8 SHTATOR (ER) - Kanë filluar punimet për realizimin e projektit të shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në fshatin Bokshiq, investim ky i Komunës së Klinës. Fillimin e punimeve për së afërmi e ka përcjellë kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, i cili ka

uruar banorët për fillimin e punimeve dhe nga kompania kontraktuese ka kërkuar që punimet të kryhen sipas kushteve dhe cilësisë së kërkuar. Ky projekt ka një vlerë buxhetore 42 500 euro dhe afat kohor prej 60 ditësh.



## Mbyllet një bastore në Skenderaj, punonte ilegalisht

SKENDERAJ, 8 SHTATOR (ER) - Drejtoria e Inspektoratit në Skenderaj, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë mbyllur

një lokal në qytet, i cili veprimtari kishte bastet sportive, e që punonte ilegalisht. Gjatë punëve rutinore ditore inspektorati komu-

nal ka konfiskuar edhe një sasi të pijeve të ndryshme në njërin prej marketeve në Skenderaj të cilat ishin pa deklaracion.

## Përrurohet këndi i lojërave në 'Parkun e Lirisë'

FERIZAJ, 8 SHTATOR (ER) - "Parkut të Lirisë" në Ferizaj i është shtuar edhe këndi i lojërave për fëmijë. Ky projekt është realizuar falë investimit të realizuar nga Komuna e Ferizajt, me qëllim rirregullimin e kësaj zone, duke maksimizuar potencialin dhe mundësitë që ofron ky park. Për të përruruar dhe parë punimet që janë kryer aty, ka dalë kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, së bashku me drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyqi dhe atë të Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Me këtë rast, kryetari Aliu ka thënë se përveç këtij investimi do të realizohen edhe disa



projekte në këtë zonë. "Sigurisht se këto hapësira, këto kënde të lojërave, begatojnë edhe më shumë këtë vend. Ky nuk do të jetë projekti i vetëm, sepse ne tashmë e kemi shpalosur projektin që dalëngadalë do të fillojë së implementuari edhe tek ish-çerdhja e vjetër e qytetit, por

sigurisht se duke u zhvilluar projekti do të zhvillohet edhe krijimi i parkut që e kam thënë edhe në rastet e tjera. Do të jetë një ndër parqet e hapësirat më të mira të qytetit", ka thënë Aliu. Ai ka thënë se ekzekutivi komunal është i vendosur t'i realizojë edhe një varg projektesh në këtë zonë siç është kompleksi argëtues e sportiv, pishina gjysmolimpike dhe stadiumi. "Synojmë që të ndërtohet bulevardi nga Qendra e Kulturës deri te kompleksi i shkollave, te Gjinnazi 'Kuvendi i Arbërit', ku edhe aty do të ketë kënde të lojërave si dhe investime të tjera infrastrukturore", është shprehur Aliu.

## Komuna e Lipjanit mbështet 55 fermerë me koshere të bletëve

LIPJAN, 8 SHTATOR (ER) - Komuna e Lipjanit ka mbështetur 55 bletarë të cilët kanë përfituar 220 koshere të kompletuara me koshere. Kryetari i kësaj komune, Imri Ahmeti, ka uruar të gjithë përfituesit duke thënë se do të vazhdojmë të punojmë së bashku që sektorin e bujqësisë ta zhvillojmë sa më shumë në komunë. "Komuna e Lipjanit ka potencial të mjaftueshëm që sektori i bletarisë të zhvillohet edhe më tutje dhe në këtë mënyrë ta ngrehim cilësinë



edhe më shumë në treg", ka thënë Ahmeti. Ndërsa përfituesit e këtyre koshereve janë ndarë të kënaqur dhe kanë falënderuar Komunën e Lipjanit dhe kryetarin Ahmeti për këtë mbështetje.

## Për sheshin në Obiliq pritet të rrenohen objektet e vjetra

OBILIQ, 8 SHTATOR (ER) - Punimet për ndërtimin e sheshit në Obiliq nuk janë duke u zvarritur për shkak të shpronësimeve, ndonëse kryetari i kësaj komune, Xhafer Gashi, pret që këtë vit të kryhen shumica e punimeve në këtë projekt. Gashi ka mohuar për "Kosovapress" të kenë telashe me shpronësime, teksa ka thënë se janë në proces të përmbylljes së

shpronësimeve. Projekti për ndërtimin e sheshit ishte nisur në tetor të vitit kaluar dhe pritet të përfundojë në shtator të vitit 2020. Objektet që presin të rrenohen janë edhe disa objekte banesore. I pari i komunës së Obiliqit ka thënë se të gjitha objektet e vjetra përreth sheshit do të rrenohen. Gashi ka bërë me dije se projekti do të zhvillohet sipas planit, derisa ka thënë se

sheshi është investim i përbashkët me Ministrinë e Infrastrukturës, ku Komuna e Obiliqit ka participuar me rreth 200 mijë euro, kurse ministria me 1 milion euro. Mësohet se edhe objekti i postës afër policisë do të rrenohet për t'u shndërruar në shesh. Ndryshe, me Ligjin e ri për Obiliqin kësaj zone i mundësohet përkrahja financiare për projekte të ndryshme.



## Në Rusi mbahen zgjedhjet lokale pas protestave të gjata

MOSKË, 8 SHTATOR - Rusia ka mbajtur zgjedhjet lokale të cilat janë "test" për qëndrueshmërinë e Kremlinit, pasi popullariteti i presidentit Vladimir Putin dhe partisë së tij po vazhdon të bie. Aktivistët liberalë dhe

ekspertët politikë janë duke vëzhguar nga afër procesin zgjedhor i cili shkaktoi shumë trazira me anë të protestave të dhunshme në kundërshtim të mohimit të pjesëmarrjes së kandidatëve të pavarur në

zgjedhje. Para zgjedhjeve, Putini kishte zëvendësuar disa kryetarë rajonalë për të shmangur përsëritjen e zgjedhjeve të kaluara ku shumë kandidatë të mbështetur nga Kremlini kanë dështuar t'i fito-

jnë zgjedhjet.

Gjërat nuk po shkojnë mirë as për Putinin. Sipas sondazheve të besimit publik, në muajin maj presidenti rus ka rënë në nivelin më të ulët për 13 vjet në pushtet.



# Presidenti Trump anuloi bisedimet e fshehta për Afganistanin

Presidenti Trump tha se i ka anuluar planet për një takim me presidentin afgan Ashraf Ghani dhe udhëheqësit e lartë të talebanëve në pushimorën presidenciale në Maryland, pas sulmit me një makinë bombë në Kabul, që la pas vetes 12 të vrarë, përfshirë edhe një ushtar amerikan

WASHINGTON, 8 SHTATOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha se ka anuluar bisedimet e fshehta që duhej të mbaheshin të dielën në Kamp David me presidentin afgan Ashraf Ghani dhe udhëheqësit e lartë të talebanëve.

Presidenti Trump shkroi të shtunën në rrjetin social "Twitter" se i ka anuluar planet për një takim në pushimorën presidenciale në Maryland, pas sulmit me një makinë bombë në Kabul, që la pas vetes 12 të vrarë, përfshirë edhe një ushtar amerikan. Ai tha se talebanët kryen sulmin për të krijuar një "pozicion të rrejshëm në negociatë". Ai tha që nëse talebanët "nuk mund të pajtoheshin për një armëpushim gjatë këtyre bisedimeve shumë të rëndësishme të paqes, madje vranë 12 njerëz të pafajshëm, atëherë me gjasë nuk kanë fuqi të negociojnë një marrëveshje kuptimplotë të paqes. Edhe sa dekada janë të gatshëm të luftojnë".

Zyra e presidentit afgan, Ashraf Ghani, lëshoi një deklaratë të dielën në përgjigje të anulimit të bisedimeve nga presidenti Trump. "Paqja e vërtetë do të ndodhë kur talebanët të pajtohen për armëpushimin", thuhet në deklaratën që e transmetoi agjencia e lajmeve Reuters.

Nuk pati një reagim të menjëhershëm të talebanëve. Negociatat për një marrëveshje të paqes janë zhvilluar për muaj të tërë ndërmjet diplomatëve amerikanë dhe talebanëve, të cilët i kanë refuzuar thirrjet për një armëpushim.

Anulimi i bisedimeve të fshehta i ka habitur analistët.

Michael Kugelman nga qendra Wilson, tha se "për muaj të tërë negociatorët amerikanë kishin punuar në mënyrë të kujdesshme për një marrëveshje. Ata ishin në prag të saj. Dhe tani, me sa duket, një postim i vetëm i presidentit Trump u ka hequr atyre rrogzin nën këmbë".

Kugelman i tha "Zërit të Amerikës" se nuk beson që bisedimet janë tërësisht të vdekura.

"Presidenti Trump është një negociator i mprehtë dhe ky mund të jetë një veprim që synon t'i frikësojë talebanët, t'i bëjë ata që ta zbusin dhunën dhe të kthehen në tryezën e bisedimeve në një pozitë më të dobët", tha ai.

David Sedney, nga Universiteti Amerikan i Afganistanit, tha se qëndrimet e presidentit Trump "ishin të papritura në dritën e negociatave që po vazhdonin në Doha vetëm pak orë më herët ndërmjet zyrtarëve amerikanë



dhe talebanëve - bisedime që grupi militant i cilësoi si shumë pozitive".

Një marrëveshje e paqes që do të çonte në tërheqjen e 14 mijë trupave amerikane nga Afganistani, do t'i jepte fund luftës më të gjatë në historinë amerikane.

Besohet se 150 mijë veta, përfshirë 40 mijë civilë, janë vrarë në Afganistan që nga viti 2001 kur pushtimi i drejtuar nga Shtetet e Bashkuara rrëzoi nga pushteti talebanët që kishin strehuar Al Qaidan dhe Osama bin Ladenin, përgjegjës për sulmet e 11 shtatorit të vitit 2001 në ShBA.

Luftëtarët talebanë kryen sulme të reja në Kabul dhe dy qytete të tjera javën e kaluar. Grupi

kontrollon tani më shumë territor sesa në çdo periudhë tjetër që nga viti 2001.

Zyrtarët amerikanë të kontaktuar nga "Zëri i Amerikës" pas deklarimeve të presidentit, refuzuan të bëjnë ndonjë koment.

Diplomati amerikan që drejton përpjekjet për një marrëveshje, Zalmay Khalilzad, tha më 31 gusht se "jemi në prag të një marrëveshjeje që do të zvogëlojë dhunën dhe do t'i hapë dyert për afganët që të ulen së bashku për të negociuar një paqe të ndershme e të qëndrueshme dhe për një Afganistan të bashkuar e sovran, që nuk kërcënon ShBA-në, aleatët e saj ose ndonjë vend tjetër".

Një projekt marrëveshje ndërmjet negociatorëve amerikanë dhe talebanëve u arrit ditë më parë, por një marrëveshje e plotë e paqes varej nga bisedimet pasuese ndërmjet afganëve.

Para deklarimeve të presidentit Trump, presidenti afgan kishte planifikuar dhe pastaj papritmas kishte anuluar një udhëtim në ShBA.

Analistët në Kabul i kishin thënë "Zërit të Amerikës" se kjo ishte një shenjë që qeveria e atjeshme nuk ishte e kënaqur me marrëveshjen e arritur ndërmjet ShBA-së dhe talebanëve dhe se ka dallime në qasjen ndaj procesit ndërmjet Kabulit dhe Uashingtonit.

## Aktivistët në Hong Kong, thirrje për presion të ShBA-së ndaj Kinës

HONG KONG, 8 SHTATOR - Aktivistët pro-demokracisë u mblodhën pranë Konsullatës amerikane në Hong Kong të dielën ndërsa përpiqen të rrisin presionin ndërkombëtar ndaj Pekinit pas tre muajsh protestash të mëdha dhe ndonjëherë të dhunshme.

Miliona njerëz kanë dalë në rrugët e Hong Kongut gjatë 14 javëve të fundit në sfidën më të madhe për sundimin e Kinës që nga dorëzimi i qytetit nga

Britania në vitin 1997.

Një turmë e madhe njerëzish, disa duke valëvitur flamurin amerikan, u mblodhën në një park në distriktin komercial të Hong Kongut dhe marshuan pranë Konsullatës së Uashingtonit.

Ata u bënë thirrje Shteteve të Bashkuara të bëjnë presion ndaj Pekinit për t'i përmbushur kërkesat e tyre dhe që Kongresi të miratojë një projektligj të propozuar së fundmi që shpreh

mbështetje për protestën.

Protestat filluan nga planet për një projektligj tani të anuluar, për t'i lejuar ekstradimet në Kinë, që shihet nga kundërshtarët si lëvizja e fundit e Pekinit për t'i cenuar liritë unike të Hong Kongut. Por pasi Pekini dhe udhëheqësit e qytetit reagueshëm, lëvizja u shndërrua në një fushatë më të gjerë duke kërkuar demokraci më të madhe, përgjegjshmëri të policisë dhe një amnisti për të arrestuarit në protesta.



# XHAVIT HAZIRI NË BRONZ

Faqet e lavdishme të popullit shqiptar do ta mbajnë me krenari të madhe brenda vetes emrin e pavdekshëm të Xhavit Hazirit



**Shkruan: Ismet  
SYLEJMANI**

Në bronz është derdhur dhe është vendosur, për të qëndruar përgjithmonë madhështor, triumfues e vertikalisht në sytë e çdo shqiptari patriot e atdhetar, lirinjerës e çlirimtar, në sytë çdo pjesëtar të rëndomtë të popullit shqiptar, në sytë e çdo qytetari të Obiliqit në veçanti e të Kosovës në përgjithësi. Përpara pallatit të kulturës në Obiliq, që e mban emrin e tij, 20 vjet pas çlirimit të Kosovës nga Serbia pushtuese, është zbuluar shtatorja e derdhur në bronz e patriotit të madh, veprimtarit të dalluar e ish të burgosurit politik, të paharruarit dhe të pavdekshmit Xhavit Haziri! Xhavit Haziri ishte figurë e madhe dhe e shquar atdhetare e radhëve të organizuara politiko-patriotike ilegale të Kosovës dhe viseve të saj.

Ishte anëtar i Komitetit Drejtues, anëtar i Sekretariatit të Komitetit Drejtues, Sekretar Politik i Komitetit Drejtues të OMLK-së e kryetar i LPRK-së brenda vendit. Xhavit Haziri ishte veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare, ishte politikan atdhetar aktiv ilegal. Anëtar i devotshëm, prijës i madh e besnik i lëvizjes politike ilegale atdhetare në Kosovë e vise. Xhavit Haziri i takon gjeneratës së jashtëzakonshme të popullit shqiptar, të veprimtarisë politike atdhetare ilegale, që kishin fatin e madh dhe përgjegjësinë historike të ishin nismëtarët e fundit të fillimit të përgatitjeve njëshekullore për luftë të armatosur çlirimtare të Kosovës dhe viseve të saj për çlirim nga Serbia pushtuese! Xhavit Haziri ishte niveli më i lartë politiko-patriotik nga lëvizja ilegale atdhetare nga Kosova, që ishte për vizitë zyrtare në Shqipëri në shtator të vitit 1991 dhe bashkë me delegacionin e OMLK-LPRK në përbërje Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu, Arif Seferi dhe Ismet Sylejmani nga Kosova dhe viset dhe Xhavit Haliti nga Dega Jashtë Vendit e LPRK-së, zhvilloi takime

të nivelit më të lartë në Tiranë dhe, mes të tjerash, u realizua takimi historik me presidentin e Shqipërisë, Ramiz Alia. Në atë takim u arrit marrëveshja historike e fillimit të ushtrimeve ushtarake të rinisë shqiptare nga Kosova e viset e saj dhe përgatitja e tyre për luftë të armatosur

nga Kosova për te presidenti shoqërohej nga personaliteti i shquar, atdhetari i madh e përfaqësuesi i lartë i Shtetit e i PPSH-së, i nderuari Kristaq Porodini.

Delegacionin, përpos presidentit Ramiz Alia, në atë takim e kishte shoqëruar me prani edhe dyshja e këshilltarëve Agron Çobani dhe Shaban Sinani. Roli i madh e aktiv, prej atdhetari e çlirimtari të Xhavit Hazirit, gjithmonë ishte në rritje, kishte kreativitet kombëtar, ishte krijues e kishte iniciativë të madhe. Xhavit Haziri i takon merita e madhe e afrimit dhe

e ndaj kombit, për pavarësinë e të cilave ishte i gatshëm të shkrihej në çdo çast.

Vlera të tilla e cilësi të larta prej udhëheqësi e drejtuesi të kalibrit e frymës skenderbegiane dhe enveriane, manifestoi kudo në tërë trajektoren e aktivitetit të tij të bujshëm, nëpër tërë kalvarin e mundimshëm të jetës e frymës me peshë të rëndë mbi supe që barte, duke përmbledhur brenda këtij kuadri edhe ngjarjet e mëdha të Lëvizjes, mbledhjet historike të saj në Prapashticë, në Ujmir, në Kollare e në Kodrën e Trimave në Prishtinë! Pushtuesit e

shqiptar të Kosovës e viseve të saj nën ish-Jugosllavi, për luftë kundër Serbisë.

UÇK-ja me ndihmën e ShBA-së dhe të aleatëve të tjerë dhe të aleancës veriatlantike NATO e bëri realitet çlirimin e Kosovës nga Serbia! Por lirisë së munguar, të shumëpritur e të merituar të Kosovës, për të cilën u derdh shumë gjak nga heronjtë dhe dëshmorët e kombit e nga populli shqiptar, i mungon fizikisht i madhi dhe i pavdekshmi, heroi i Kosovës Xhavit Haziri.

Ardhja e Tij, i shkrirë në bronz, e zëvendëson, ndonëse shumë



çlirimtare kundër pushtuesve. Xhavit Haziri me atë udhëtim historik bashkë me delegacionin që e shoqëronte u bë figura më e madhe çlirimtare e historike, e cila në pallatin presidencial të Shqipërisë në krye të delegacionit arriti vendimin e madh, realizoi ëndrrën historike të gjyshërve e stërgjyshërve nga Kosova e viset e saj, për fillimin e përgatitjeve ushtarake për luftë të armatosur çlirimtare e frontale kundër Serbisë pushtuese. Në atë takim delegacioni në përbërje të ngushtë

lidhjes së marrëveshjes për bashkëpunim në mes të LPRK-se dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe kryetarit të saj, prof. dr. Hajrullah Gorani! Gjithashtu, Xhavit Haziri i takon merita e madhe e afrimit dhe mbajtjes afër e në bashkëpunim të plotë me LPRK-në, të Klubit Demokratik Shqiptar dhe kryetarit të saj prof. dr. Muhamet Mehmeti. Te figura e personaliteti i tij, qysh moti ishin të shkrira e të harmonizuara, të skalitura e të gdhendura dashuria ndaj atdheut

riburgosën dhe e dënuan me vite të shumta burg, por shpirtin kryengritës, revolucionar e të vendosur për çlirim, nuk ia thyen kurrë. Xhavit Haziri mbetet një ndër figurat më emblematike të luftëtarit kombëtar, i cili kishte fatin e madh të ishte i pari në ballë të delegacionit nga Kosova, që solemnisht arriti marrëveshje historike me presidentin e Shqipërisë, Ramiz Alia, për fillimin e madh të aftësimit profesional, ushtarak e çlirimtar të njësiteve të para të popullit

pak, mungesën edhe të varrit të tij. Tani familja e ngushtë dhe e gjerë, farefisi dhe miqtë, ne shokët e bashkëveprimtarët kemi ku të shkojmë e të nderojmë heroin e Kosovës Xhavit Haziri. Faqet e lavdishme të popullit shqiptar do ta mbajnë me krenari të madhe brenda tyre emrin e pavdekshëm të Xhavit Hazirit! Lavdi e përjetshme!

**(Autori ka qenë anëtar i Komitetit Drejtues, shok e bashkëveprimtar me heroin e Kosovës, Xhavit Haziri!)**

## Njihuni me pasionet me Miss Italia 2019



Është 20 vjeçe, ka sy jeshilë, flokë gështenjë dhe një fizik të mrekullueshëm. Quhet Carolina Stramare dhe është shpallur më e bukura në edicionin e 80 të Miss Italia. Ajo studion në Akademinë e Arteve të Bukura në Sanremo, por

është edhe modeluese. Në konkursin e bukurisë ajo është paraqitur si Miss Lombardia. Ajo i adhuron kafshët dhe prej tetë vjetësh praktikon sportin e hipizmit. Pasionet e saj janë moda dhe udhëtimet. Për fatin e keq të beqarëve, ajo është e fejuar!

## "Kapitenia" e DAZN-it shkëlqen në festën e ditëlindjes



Bukuroshja e njohur e ekraneve sportive në Itali, Diletta Leotta, ka festuar 28-vjetorin e lindjes nën shoqërinë e miqve më të afërt. Në fotot e shpërndara në rrjetet

sociale, "kapitenia" e ekipit të transmetimit DAZN është shfaqur në top-formë në ditën e veçantë të jetës së saj teksa kishte zgjedhur të veshë një fundrrjetë tejet provokues.



## Taylor Swift dhuron 100 mijë dollarë për fansen me kancer

Taylor Swift ka dhuruar 100 mijë dollarë për t'i ndihmuar një fansë që ka kancer. Këngëtarja 29-vjeçare dëshironte ta ndihmonte 16-vjeçaren Trinity Foster rreth faturave të saj mjekësore. Ajo është diagnostikua me kancer të shkallës së katërt, pasi është përhapur në mushkëritë e saj.

"Trinity, pashë fotot që ke bërë në dhomën tënde të spitalit dhe desha të them faleminderit që ke qenë kaq e mirë dhe mbështetëse. Shpresoj që së shpejti t'ju jap një përqafim por, ndërkohë, kam dashur të dërgoj gjithë dashurinë time për ty", ka shkruar Taylor së bashku me njoftimin për dhurimin e parave.

## Ndahen Zooey Deschanel dhe Jacob Pechenik



Zooey Deschanel dhe Jacob Pechenik nuk janë më bashkë. Aktorja 39-vjeçare dhe regjisori 47-vjeçar janë ndarë pas katër vjetësh martesë, ka konfirmuar një burim pranë çiftit në një prononcim për "Just Jared". "Pas shumë diskutimesh, ata kanë vendosur të jenë vetëm miq,

partnerë afaristë dhe bashkëprindër sesa partnerë të jetës. Faleminderit që respektuat privatësinë në këtë kohë!", ka thënë ky burim. Zooey Deschanel dhe Jacob Pechenik ishin fejuar në janar të vitit 2015 dhe u patën martuar në qershor të atij viti. Ata kanë dy fëmijë së bashku.

E rrallë

## 300 pemë, 6 tonë secila

Stadiumet e futbollit janë sinonim i zhurmës dhe rrëmujës, por një instalacion arti në Austri ka sjellë një pyll të vërtetë në mes të një stadiumi futbollit në përpjekje për ta tërhequr vëmendjen ndaj ndryshimit të klimës dhe shpyllëzimit. "Wörthersee Football Stadium" në Klagenfurt është shndërruar në një pyll të mrekullueshëm për një projekt të ri nga artisti zviceran Klaus Littmann. Fusha e madhe, e vendosur afër liqenit Wörthersee



në shtetin jugor austriak të Carinthia, tani është rreshtuar me rreth 300 pemë, disa që peshojnë deri në gjashtë tonë secila.

FOTO E DITES



Një zjarrfikës duke shuar zjarrin në një depo në Almaty, Kazakistan. /Reuters/

E jashtëzakonshme

## Zbulohet gjeni përgjegjës që shkakton varësinë ndaj drogës

Shkaku i krijimit të varësisë nga kokaina është një gjen. Përdorimi i vazhdueshëm i kësaj substance ndikon në modifikimin e një gjeni duke e bërë atë më aktiv, pikërisht në një zonë të trurit që është përgjegjëse për memorien dhe të kuptuarit. Sipas studiuesve, kur ky gjen është aktiv truri i një personi të varur nga droga ka lidhje më të forta si me sub-



stancën ashtu edhe me rrethanat dhe mjedisin ku merret, gjë që kujtohet dhe rikujtohet vazhdimisht nga personi. Studimi

është kryer nga Universiteti i Miçiganit dhe është publikuar në revistën shkencore "Neuroscience". Eksperimentet janë bërë mbi kaviet në laborator dhe kur studiuesit kanë bllokuar modifikimet e këtij gjeni përgjegjës që e kanë quajtur "FosB", atëherë nuk verifikohet lidhja mjedis-droga, duke sjellë edhe mungesën e varësisë.

## BARSOLETA E DITËS



**Shitësi dhe blerësi**  
**Blerësi: A keni parashutë?**  
**Shitësi: Po, origjinale.**  
**Blerësi: Jeni i sigurt?**  
**Shitësi: Nëse nuk ju hapet, lirisht mund ta ktheni!**




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min  
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

#### GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

#### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.  
 Regjia: David Leitch




#### Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.



**DASHI**  
Të lindurit e kësaj shenje i pret një fundjavë e lodhshme. Do të ndiheni të shqetësuar lidhur me disa projekte të cilat duhet t'i përfundoni sa më parë.



**DEMI**  
Kjo ditë do të jetë mjaft e favorshme për ju në sajë të ndikimit të Hënës në shenjën tuaj. Nëse jeni vetëm, përgatituni për takime interesante.



**BINJAKËT**  
Nëse jeni përballur me debate në familje apo me partnerin/en, mos u shqetësoni, pasi çdo gjë do të sistemohet.



**GAFORRJA**  
Gjatë kësaj fundjave më në fund do të mbusheni me frymë, pas problemeve profesionale dhe ligjore që keni pasur.



**LUANI**  
Pas një fillim jave pozitive, do të përballeni me një sërë ndryshimesh. Bëni mirë që t'i dëgjoni të afërmit tuaj dhe t'i mbështesni nëse ju kërkojnë ndihmë.



**VIRGJËRESHA**  
Pas disa ditëve të ngarkuara me stres, më në fund do të ndiheni më mirë. Nëse mundni, dilni sa më shumë, pasi yjet janë në anën tuaj dhe premtojnë çlodhje.



**PESHORJA**  
Këshillohet që gjatë kësaj të shtune t'i shmangni zënkat me njerëzit tuaj të dashur. Duhet të jeni sa më të durueshëm, pasi situatat e ngarkuara do të kalojnë shumë shpejt.



**AKREPI**  
Mbushuni me energji këtë fundjavë, e meritoni. Pas javëve të vështira që keni kaluar, ka ardhur momenti që të qetësoheni.



**SHIGJETARI**  
Ka ardhur koha për t'u përballur me disa situata të mbetura pezull. Bëni mirë që të mos i shtyni projektet e reja, pasi është momenti për të vepruar.



**BRICJAPI**  
Hëna do të ketë ndikim mjaft të favorshëm dhe do t'ju mbushë me energji. Për këtë arsye do ta gjeni forcën të punoni për një projekt të cilin e keni shumë përzemër.



**UJORI**  
Kjo fundjavë do të jetë e mbushur me emocione. Nëse jeni vetëm ka ardhur koha ta hidhni hapin e parë ndaj një personi që e keni shumë përzemër.



**PESHQIT**  
Do të keni mundësi që të memi kënaqësi të mëdha mes fundjavës dhe fillimit të javës që vjen. E shtuna do të mundësojë rikuperim energjish.



<b>Autor:</b> GAZMEND MORINA	AKTORJA DHE MODELJA AMERIKANE NË FOTO	PASANIKE	KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE ("KALLE MOS TA NIN")	E MITUR		AKTORJA HOLLIVUDIANE ..... COUPE SHTRESË E SIPËR E AJRIT
NDODHI QË TREGOHET ME GOJË; TREGIM ME GOJË (krah.)						
E TURPËROJ						
BANORE E NJË SHTETI AFRIKAN						
PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE				FLORI EMBLEMA		
AZOT, URANIUM			BASHKËT. FLUTURAKE JASHTËTO- KËSORE	OLIVER NEUVILLE	PJESË E VOGËL MUZIKORE ME KARAKTER LIRIK (shq.)	
QË JEP PEMË						VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKË
ZANORE		I JASHTËZ- AKONSHËM, I VEÇANTË QYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)				QYTET NË GJERMANI

<b>SUDOKU</b>									
		3							
								2	6
									5
		2		4	5			3	
				3				8	9
		5	4		1	7			
		8	3		7				
		4		8	6		1		
		3	5	9					
									7

<b>EPOKA ERE</b>	SASI E PRODHIMEVE QË MUND TË NXJERRË NJË FABRIKË	THARTIRA, THARTINA (kim.)	HUNDORËSI, MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVE (ling.)		DIÇKA E FITUAR ME PUNË TË PANDERSHME DJALI KUNDREJT PRINDËRVE	LLOJ METALI INTERNATIONAL MARITIME ORGANIZATION		FUTBOLLISTI ITALIAN AMBROSINI "MOLDE"						
LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.)							BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.) KLUB I YNI FUTBOLLI							
FTOHJE E MARRËDHI- ENIEVE NDËRMJET DY SHTETEVE						DY BASHKË- TINGËLLORE		BASKETBOLL- ISTI TURK OMER .... SHPIRT I KEQ, DJALL				NEVADA, ARIZONA ATALANTA		
FUTBOLLISTI PERUAN KLAUDIO (WERDER BREMEN)						AKTORI YNË ... ISLAMI AKTORI MORINA		DY BASHKË- TINGËLLORE			AUSTRALIAN DESIGN RULES NAIROBI, UGANDA			
MASHKULLI I PARË						QILIM QË SHTROHET NË NJË ANË TË DHOMËS MAKINË GURTHYESE		PJESËTAR I AONËVE PRARAJ			DY ZANORE AKTORI I FAMSHËM HOLLIVUDIAN EDWARD			
KUSH					THIRRMA E FORTË, KLITHMA DEM					KUMBARË PËRRUA I NGUSHTË DHE I THELLË		JEMENI, ARMENIA	VËLLAI I MADH	
INTENSITET, TITAN					POSEDOJ DIÇKA SHKRONJA TË NJËJTA		ARTERIA MË E MADHE E ZEMRËS AUTORITETI QË KA DIKUSH MBI DIKË				THURJA, QËNDISJA VLERË, DOBI (krah.)			
KATËRKË- NDËSH (gjeom.) I SHËMTUAR (krah.)							SHPEND UJI SHTEGTAR SFOND SHKRONJASH			LLOJ PESHKU ILAÇE				
					FUTBOLLISTI HOLANDEZ ... VAN DER MEYDE (shqip.) ANËTARËSIM NË NJË PARTI			EMËR YNI MASHKULLI GJERMAN I VJETËR				ZANORE BASHKËT.		
HISTORIANI ROMAK LUKRECI					EMËR YNI FEMRE SHTETI (huaj)				QË LIDHET ME ORGANIN E TË PARIT QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip. - shq.)				VEGËL MUZIKORE	
<b>EPOKA ERE</b>	REGJISORI ... SOPI	VEGËL MUZIKORE ME FRYMË	AKTORI I FAMSHËM ... MARFI TË LUTEM (fet.)			KAFSHË SHTËPIAKE (shq.) BASHKËT.				QYTET NË FRANCË (shqip.) QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE (vjet.)			BASHKËT. LLOJ VETURE FRANCEZE	
FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)						FILLESTAR GRIMCOVA (bised.)						ALUMIN DEGË E VEPRIMTARI- SË KRIJUESE ARTISTIKE		
KAFSHË QË MBAHET NË SHTËPI PËR NGARKESË (shq.) APROVIMI						POET-JA JONË AHMETI ILION LIKA					GURRA SHKRONJA TË NJËJTA			
							QYTET FRANCEZ I FILMIT ELFSBORG			BISHË MALI SHKRONJA XXIV				
E SHKALLËS MË TË ULËT A E CAKUT MË TË POSHTËM													SHKRONJA XXVIII	

ZGJIDHJA E FJALËKRËYQIT: E, MESELE, E KORIT, GANZE, AMI, AR, NU, S, FRUTOR, O, FENOMENAL, KROM, MASIMO, KANABISI, AMARETAT, ACARIMI, SD, ONAN, NA, PIZARO, ARD, CT, ADR, ADAMI, ANIE, AON, NI, ITI, BRITMA, NUN, ITI, KAM, KAM, AORTA, OJA, TETRAGON, NOR, KRAP, BETER, ENDI, SABIT, A, TIT, ARDITA, PAMOR, EDI, KALI, REN, F, ABATE, DILETANT, AL, GOMARI, MIMOZA, AMA, MITARIMI, KANA, ARIU, MINIMALE, NITRAT, T. ZGJIDHJA E SUDOKUT: Koiona 1:536 792 481; KII:974 318 265; KIII:812 645 937; KIV:721 536 894; KV:699 481 723; KVI:483 279 516; KVII:247 863 159; KVIII:359 127 648; KIX:168 954 372.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Kosova duhet të mos dorëzohet ndaj Anglisë

Genc Sermaxhaj ka thënë se, pavarësisht se Anglia është një ndër kombëtare të më të forta në botë, Kosova duhet ta aplikojnë lojën e vet dhe të dëshmojë se rezultatet e gjertanishme nuk janë të rastësishme. "Në anën tjetër edhe Kosova nuk duhet të dorëzohet, madje duhet ta luaj lojën e njëjtë edhe ndaj anglezëve që, së paku, të dëshmojë se nuk jemi rastësisht këtu", ka thënë Sermaxhaj

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 SHTATOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll arriti fitore të rëndësishme të shtunën ndaj Çekisë (2-1) në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian. Analisti dhe trajneri i futbollit, Genc Sermaxhaj, për "Epokën e re" ka vlerësuar se fitorja e "dardanëve" erdhi në sajë të angazhimit maksimal. "Fitorja erdhi në bazë të angazhimit dhe vetëmohimit të futbollistëve tanë, që po vazhdojnë të na bëjnë krenarë me atë se çfarë po tregojnë në fushën e lojës. Taktikisht luajtëm mirë në mes-fushë dhe ishim mjaft vigjilentë në shfrytëzimin e rasteve.

Kosova do të duhej që me shumë ta kontrollonte lojën, por edhe mungesat në disa çaste u vërejtën, prandaj atë që bënë lojtarët tanë ishte e mjaftueshme dhe pozitive për tri pikë shumë të rëndësishme", ka thënë Sermaxhaj. Ish-futbollisti i shumë skuadrave, por edhe i Përfaqësueses së Kosovës para pranimit në UEFA dhe FIFA, ka folur edhe për ndeshjen e radhës që Kosova e zhvillon më 10 shtator kundër Anglisë. Ai është shprehur i rezervuar në lidhje me suksesin e mundshëm, por ka kërkuar që futbollistët ta japin maksimumin. "Duhet të jemi me këmbë në tokë. Humbja një ditë do të vijë, por duhet të tregohemi të kujdesshëm ndaj Anglisë, pasi është superfuqi e futbollit botëror. Në anën tjetër, edhe Kosova nuk duhet të dorëzohet, madje duhet të luaj njëjtë edhe ndaj anglezëve që, së paku, të dëshmojë se nuk jemi rastësisht këtu. Pres një lojë të mirë nga lojtarët e Kosovës. Pse mos t'i shkaktojmë probleme një kombëtare kaq të fortë", ka

deklaruar Sermaxhaj.

Kosova aktualisht pozicionohet në vendin e dytë në Grupin A me tetë pikë të grumbulluara, Anglia ka një pikë më shumë se "dardanët", por edhe një ndeshje më pak të zhvilluar.

## Kosova sot udhëton drejt Anglisë

Përfaqësuesja e Kosovës të dielën ka zhvilluar stërvitjen për ndeshjen ndaj Anglisë. 12 futbollistë ishin të pranishëm në stërvitje, përfshirë edhe Valon Berishën, Elbasan Rashanin e Florent Muslien, të cilët u paraqitën në ndeshjen ndaj Çekisë. Ndërsa lojtarët e tjerë janë lënë në pushim. Ekspedita e "dardanëve" do të udhëtojë sot (e hënë) drejt Anglisë, ku të martën do ta zhvillojë ndeshjen kualifikuese të radhës.

## Vojvoda, pjesë e formacionit të javës në kualifikime për 'Euro 2020'

Mbrojtësi i djathtë i Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, e ka zënë një vend në formacionin e ndeshjeve të para kualifikuese për muajin shtator. Vojvoda e shënoi golin e fitores për Kosovën në përballje me Çekinë (2-1) në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Mbrojtësi shqiptar ka zënë vend krahas botërorëve si Ramos, Varane, De Jong e Kane.

## Southgate: Ndeshja me Kosovën është kryesorja në grup

Përfaqësuesja e Kosovës e mposhti Republikën Çeke në



kualifikimin e "Euro 2020", me rezultat 2-1. Trajneri Gareth Southgate ka shprehur vlerësime për paraqitjet e deritanishme të Kosovës në kuadër të Grupit A kualifikuese për "Euro 2020", duke thënë se ndeshja kundër Kosovës

do të jetë kryesorja në grup. "Ndeshja me Kosovën është kryesorja në grup, sipas meje. Jam shumë i impresionuar me Kosovën. Është një ekip i organizuar mirë, me lojtarë të mirë. E ka pasionin e një kombëtareje të krijuar së fundi.

Rezultati i tyre nuk më ka befusuar aspak. I kam parë që luajnë mirë edhe në ndeshjet paraprake. Me ta duhet të luajmë më mirë se ç'luajtëm me Bullgarinë. Të martën do të jetë një test i mirë për ne", ka thënë Southgate.

## Cana: Talentet më të mëdhenj tani luajnë për Kosovën

**PRISHTINË, 8 SHTATOR** - Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, ka thënë në një intervistë për "SO FOOT" se tash talentet më të mëdhenj luajnë për Kosovën. Me këtë rast ish-mesfushori kuqezi thotë se në kohën kur Shqipëria u kualifikua në "Euro 2016", gjysma e lojtarëve ishin me orgjinë nga Kosova. "Ne e dinim prej shumë vitesh se shqiptarët me origjinë nga Kosova do të ktheheshin natyrisht drejt Kosovës. Tani nuk

kemi një ekip kombëtar të Shqipërisë, por dy ekipe që përfaqësojnë dy shtete, Shqipërinë dhe Kosovën. Dhe talentet më të mëdhenj aktualisht luajnë për Kosovën. Në të ardhmen do të kemi shumë vështirësi të rigjejmë gjenerata të afta të pretendojnë përsëri një kualifikim në Evropian. Dhe nëse një ditë Kosova do të kualifikohet për një turne madhor, Shqipëria do të jetë në mënyrë të pakundërshtueshme pas Kosovës. Përveç kësaj, në ekipin e Shqipërisë që



u kualifikua në "Euro 2016", gjysma e lojtarëve ishin me origjinë nga Kosova".

## Leclerci triumfoi në Itali

**MONZA, 8 SHTATOR** - Piloti Charles Leclerc triumfoi në garën për Çmimin e Madh të Italisë. Piloti i dytë i Ferrarit

fitoi i vetëm duelin me Mercedesin, duke i lënë pas shpine Bottasin dhe Hamiltonin. Përgjatë gjithë

garës ishte një duel tepër i fortë mes 22-vjeçarit të Ferrarit dhe kampionit të botës, por në fund Hamiltoni

gaboi vetë në një kthesë, duke humbur edhe vendin e dytë ndaj shokut të skuadrës, Valteri Bottas. Vendi i katërt i

takoi Ricciardo të Red Bullit, ndërsa pas tij u renditën Hulkenbergu, Albani, Perezi dhe Verstappeni.



## Ish-asistenti i Contes, trajner i Vushtrrisë

**VUSHTRRI, 8 SHTATOR** - Skuadra elitare e futbollit të Kosovës, Vushtrria, për herë të parë në historinë e saj e ka emëruar një trajner të huaj. Bëhet fjalë për trajnerin italian Benvenuto Antonio Toma, i cili ka një karrierë mjaft të pasur në futbollin italian. "Po e hapim një kapitull të ri për klubin. Për herë të parë një

trajner i huaj nënshkruan me Vushtrrinë. Benvenuto Antonio Toma, i lindur në Maglie të Italisë, tekniku 56-vjeçar, ish-asistent i njërit nga emrat më të mëdhenj të futbollit botëror Antonio Conte, në sezonin 2009\10 ishin së bashku pjesë e klubit të njohur italian Atalanta në Serinë A, më pastaj për ta

vazhduar karrierën në klubin tjetër të njohur Lecce, fillimisht si trajner i grupmoshave U19 për dy vjet me radhë, pastaj si kryetrajner në vitin 2013. Strategu italian e kishte udhëhequr Leccen në 13 ndeshje në Serinë C, duke arritur tetë fitore dhe tri barazime, për t'u kthyer prapë për tre vjet të tjera si trajner i grup-



moshave të reja deri në vitin 2017. Në verën e këtij viti në mediet italiane ishte përfolur për një ribashkim

të mundshëm në stafin e Contes tek Interi", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vushtrrisë.

# Hadërgjonaj rrëfen përjetimin e luftës para ndeshjes me Anglinë

**LONDËR, 8 SHTATOR** - I lindur dhe rritur në Zvicër, Florent Hadërgjonaj i Huddersfieldit pranoi të luajë për Kosovën më herët gjatë vitit. Duke pasur parasysh historinë e ekipit më të ri të futbollit, ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme për mbrojtësin 25-vjeçar. Kështu nis një artikull për Kosovën dhe Hadërgjonajn nga "Daily Mail", e cila ka biseduar me kosovarin para ndeshjes të së martës me Anglinë në kualifikueset për "Euro 2020". "Kur lojtarët tanë ulen dhe bisedojnë nuk është veç për futbollin", ka thënë Hadërgjonaj. "Të gjithë e kanë rrëfimin e tyre. Ata që s'ishin në Kosovë gjatë luftës i dëgjojnë ata që ishin. Ne dëgjojmë nga bashkëlojtarët tanë tekta flasin për ecjet gjatë maleve për të ikur në kohën sa ishin fëmijë. Pa ushqim, duke ecur për dy apo tri ditë, me të shtënat përreth. Është emocionuese sepse e kupton se edhe familja, xhaxhallarët, kushërinjtë, mund të ishin përballur me të njëjtën gjë", ka thënë ai.

"Daily Mail" vazhdon më tej duke shkruar për Kosovën si pjesë e ish-Jugosllavisë dhe ndarjen me luftë, që çoi në vrasjen e rreth 14 000 personave e shpërnguljen e shumicës së popullatës. Tregohet, po ashtu, edhe historiku i pasluftës, duke theksuar shpalljen e pavarësisë më 2008 e pranimin në futbollin ndërkombëtar më 2016. Futbollit po shihet si rrugë përpara për popullin e ri. Hadërgjonaj, që debutoi për "Brazilin e Ballkanit" ndaj Bullgarisë në qershor, e di përgjegjësinë që kanë. "Ekipi i futbollit tregon fytyrën e mirë të shtetit tonë. Lojtarët tanë janë të lindur në shtete të ndryshme, por janë bërë bashkë për të krijuar gjëra. Dashuria për futbollin është e çmendur. Kemi mposhtur Bullgarinë në Sofje dhe qindra fansa ishin në aeroport deri në tre të natës për të na përshëndetur. Nëse dalim për të ngrënë, nuk na lënë të paguajmë. Ushtrimet janë sikur ndeja argëtimi. Njerëzit shikojnë dhe lëshojnë muzikë. Nuk mund ta imagjinoj se si do të ishte po që se do kualifikoheshim për "Euro 2020", ka deklaruar më tej Hadërgjonaj, që të shtunën luajti në krahun e majtë në fitoren 2 me 1 ndaj Çekisë. Një arritje e tillë s'është imagjinare. Kosova jo vetëm që ka pasion, por është e mirë. Ekipi aktual përbëhet nga lojtarë prej 14 ligash, përfshirë Italinë, Rusinë, Gjermaninë e katër nga "Championshipit" anglez, vazhdon tutje "Daily Mail". Aty, po ashtu, theksohet se edhe nëse Kosova nuk arrin në top-dy të tabelës në Grupin A kualifikues, ekziston akoma shansi për kualifikim në "Euro



2020" përmes "play-off"-it në Ligën e Kombeve e ku do të përballen në gjysmëfinale me Maqedoninë. Ceket se në atë kohë gati do të jenë Arbër Zeneli e Milot Rashica që po mungojnë për shkak të lëndimeve. Historia e Hadërgjonajt është e veçantë. Prindërit e tij lanë Kosovën për një jetë të re në Zvicër para se të nisnin telashet. Ai ishte veç pesë vjeç kur shpërtheu lufta. "Kam sigurisht informacione, por ishte më vonë kur e kuptova në të vërtetë se çka kishte ndodhur", ka shpjeguar ai. "Ishte vështirë për prindërit e mi. Pjesa tjetër e familjes sonë po luftonte për jetët e tyre dhe nuk mund të bënim asgjë. Babai im kishte kushërinjtë që ishin në ushtri dhe u vranë. Kur kthehem tash në Kosovë, vizitoj familjet, gratë pa burra e fëmijët pa etërit. Ndihej me fat që kam qenë në Zvicër. Më dha gjithçka dhe më mundësoi të bëhem futbollist", ka shtuar ai. Kur u formua ekipi përfaqësues i Kosovës, yjet botërore si Xherdan Shaqiri e Granit Xhaka mbetën në ekipin kombëtar të Zvicrës dhe nuk ndërruan ambient. Hadërgjonaj ishte, po ashtu, pjesë e Zvicrës, U-21, por vendosi të bashkohej me bashkëlojtarët Bersant Celina, Aro Muriq e Atdhe Nuhiu në Kosovë. Të gjithë janë pjesë e "Championshipit", rangut të dytë të futbollit në Angli. "Ishte vështirë të vendosja. Zvicra u dha prindërve të mi jetë më të mirë, por edhe unë kisha familjen që ka luftuar për një shtet që po rritet. Në fund, ishte se si ndiheshja brenda. Kam folur sinqerisht me Federatën e Zvicrës dhe jam falënderues që më kanë mirëkuptuar dhe nuk e kanë bërë të vështirë për mua", ka thënë tutje Hadërgjonaj.

30-vjeçari Nuhiu, pjesë e Sheffield Wednesdayt, bashkëlojtar i

Hadërgjonajt te Kosova, kishte udhëtuar si fëmijë nga Kosova drejt Austrisë. Ai e mban mend traumën e viteve 90, me thirrjet telefonike nga vendi i ri të afërmit që po iknin nga bombat në vendlindje. Loja ndaj Anglisë për herë të parë është thjesht simbolike se deri ku ka arritur Kosova, një rritje e reflektuar në ngjitjen në vendin e 120 të ranglistës së FIFA-s. Pas dështimit me Huddersfieldin sezonin e shkuar në Premierligë, Hadërgjonaj përvojë fitoreve e shijoi me Kosovën më 2019. Mbrojtësi i krahut ka përvojë më shumë se bashkëlojtarët me përballjen me lojtarët anglezë. Harry Kane, Marcus Rashford e Raheem Sterling nuk kanë shënuar asnjëherë ndaj tij nga loja e hapur, edhe pse thotë se kjo s'duhet t'i bëjë të ndihen rehat bashkëlojtarët. "Lojtarët e tjerë më kanë pyetur se si janë futbollistët anglezë. U kam thënë 'Djem shikoni videot, nuk mund t'ju ndihmoj'", ka thënë duke qeshur Hadërgjonaj. "Anglia ka lojtarë të mrekullueshëm. Duken të rrezikshëm në TV, por duhet t'u them, është edhe më vështirë në fushë". "Kosovarët do të vijnë nga çdo vend për këtë ndeshje. E donim 'Wembleyn' para Southamptonit por, ndoshta, një stadium më i vogël do të jetë më mirë për ne, 30 mijë në vend të 80 mijëve. Kam luajtur në 'St Mary's' më herët dhe kam barazuar 1 me 1. Do ta pranoja këtë rezultat tani", ka përfunduar ai. Anglia e Kosova i prijnë Grupit A. Anglia pas tri ndeshjeve ka nëntë pikë, ndërsa Kosova është e dyta me një pikë më pak, por me një ndeshje më shumë. Çekia është e treta me gjashtë pikë, ndërsa grupin e mbyllin Mali i Zi dhe Bullgaria me nga dy pikë. Angli - Kosovë luhet të martën me fillim prej orës 20:45.

## SHKURT

### Mavraj: Nuk e di pse e bëni kaq dramatike, Franca nuk është niveli ynë

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, nuk e cilëson dramë humbjen 4-1 ndaj Francës. "Nuk është Franca që ishte atëherë, edhe ne nuk jemi në të njëjtën situatë. Me top ata ishin shumë të fortë, kishin cilësi shumë të lartë. Në mbrojtje nuk ishin aq mirë. Ne nuk kishim guxim. Nuk e shikoj dramatike ndeshjen, siç e shihni ju, duke ditur ku luajtëm. Himni? Nuk kërkuam asgjë më shumë se himnin kombëtar. Na jep shumë motivim. Pse mos t'i kërkojmë të drejtat tona. Krahësimi me tre vjet më parë? Nuk e di pse e bëni kaq dramatike, Franca nuk është niveli ynë", ka deklaruar Mavraj.

### Khabibi fiton titullin ndaj Poirierit

Khabib Nurmagomedov është rikthyer pas më pak se një viti në kafaz për ta vendosur kampionin absolut të peshës së lehtë të UFC ndaj Dustin Poirierit. Luftëtari i pamposhtur nga Dagestani i Rusisë ka fituar me "submission" në raundin e tretë të sfidës. Rusi ka dominuar në dy raundet e parë pasi e kishte shumë të thjeshtë që ta ulte në tokë amerikanin falë mundjes së tij. Megjithatë, duhej prituri raundi i tretë që Poirier më në fund të dorëzohej. UFC 242 në Abu Dabi ka përfunduar ashtu siç pritej, me Khabib kampionin e padiskutueshëm.

### Matthaus lavdëron kundërshtarët e Bayernit

Ish-ylli i Gjermanisë dhe Bayern Munich, Lothar Matthaus, i ka thurur elozhe Leipzigut, që kryeson Bundesligan me pikë të plota pas tri javëve të para të kampionatit. "Kanë një skuadër shumë të fortë, siç kanë treguar edhe sezonin e kaluar, duke zënë vendin e tretë dhe tani kanë gjetur një ekuilibër mes mbrojtjes dhe sulmit. Trajneri Nagelsmann mund t'i japë më shumë freski ekipit dhe mund të krijojë një komunikim më të mirë me lojtarët", ka thënë Matthaus.

### Barça i ofron kontratë të përjetshme Messit

Kampionia e La Ligas, Barcelona, është në bisedime të vazhdueshme me Leo Messin dhe agentin e tij, për rinovimin e kontratës. Barça po tenton ta bindë Leon ta nënshkruajë një kontratë të përjetshme me klubin, raporton 'Mundo Deportivo'. Presidenti i skuadrës katalane, Josep Maria Bartomeu, ka konfirmuar gjatë kësaj jave se 32-vjeçari mund të largohet nga skuadra në fund të sezonit për shkak të klauzolës në kontratë. Megjithatë, Barcelona duket e vendosur që ta mbajë lojtarin edhe më gjatë se viti 2021, kur kontrata e tij skadon. Synimi është kontrata pa afat.

C.nr.203/19

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin e vetëm gjykuces Binak Duqi dhe Zyrtaren Ligjore Dalina Kërçeli, në çështjen juridiko civile të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve – BKS me seli në Prishtinë kundër të paditurit Ekrem Havolli me adresë të fundit në Podujevë rr. "H. Zejnullahu", pn., për rimbursim dëmi në vlerë prej 11.765.00 euro, duke vendosur sipas padisë së paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në seancën përgatitore publike, më datë 26.08.2019, merr këtë:

**AKTVENDIM**

Caktohet si përfaqësues i përkohshëm Remzi Potoku, avokat nga Podujeva, për të paditurin paditurit Ekrem Havolli me adresë të fundit në Podujevë rr. "H. Zejnullahu", pn., pasi që nga fletë kthesat thuhet se pala është e panjohur në këtë adresë.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurorë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**Arsyetim**

I padituri Ekrem Havolli me adresë të fundit në Podujevë rr. "H. Zejnullahu", pn., u ftua nga ana e gjykatës por nga fletë kthesa thuhet se pala është i panjohur në këtë adresë, prandaj edhe përfaqësuesi i autorizuar i paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve – BKS me seli në Prishtinë, ka propozuar që të njëjtit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurorë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga e gjitha kjo u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 79.3 nën b) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil**  
C.nr.203/19 më dt. 26.08.2019

Gjyqtari:  
Binak Duqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykatë.

Certified translation from Albanian language

C.no.203/19

**BASIC COURT IN PRISHTINË – BRANCH IN PODUJEVË, General Department – Civil Division**, in the quality of first instance civil court with single adjudicating Judge Binak Duqi and Legal Assistant Dalina Kërçeli, in civil matter of Kosovo Insurance Bureau – KIB seated in Prishtinë against the respondent Ekrem Havolli, last known address in H. Zejnullahu Street n.no, in Podujevë, pertaining to damage reimbursement in the amount of € 11,765.00, upon deciding pursuant to the claimant's claim on the appointment of the provisional representative in the public preliminary hearing on 26.08.2019 renders the following:

**RULING**

